



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 613/1 prot.

Tiranë, më 14/06/2021

V E N D I M

Nr. 108, Datë 14 / 06 / 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.150 Regj, datë 10.12.2020, paraqitur nga ankuesit L.B dhe A.N, kundër M.I, me detyrë Shefe Shërbimit të Labororit të Anatomisë-Patologjike², pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”³, me pretendimin për diskriminim për shkak të *bindjeve fetare, gjendjes martesore, gjendjes arsimore dhe përkatësisë në një grup të veçantë*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas ankuesve, M.I është e njohur në ambientet spitalore dhe pedagogjike si person konfliktual dhe fyes ndaj kolegeve të të njëjtit nivel apo edhe vartësve. Ndaj L.B dhe Dr.T.B (bashkëshortja e ankuesit) fyerje të tilla si “muslimanë të qelbur”apo “fondamentalistë islamikë” janë thënë në prezencë të personave të tretë dhe jo përballë, duke abuzuar me besimin e dy mjekëve që janë praktikantë të besimit musliman. Terminologji të tilla si “*bashkëshortët B. apo çifti B.*” përdoren në zhargonin e Shefes së Shërbimit, në bisedat e zakonshme, por edhe në dokumentacionin e shkruar. Sipas ankuesve, grupimi i stisur i punonjësve në baza krahinore, me terminologji të tilla si “*Malokët*” apo edhe “*Shkodranët*”, për të krijuar ndasi në kolektivin e punës, është praktikë e zakonshme e Shefes së Shërbimit. Terminologji të tilla si “copë laborante, copë specializante,

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Shefe e Shërbimit.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën QSUNT.

rrugaçe” apo shprehje të tilla si “*Po të isha burrë do ju tregoja unë juve....*” në mbledhjen e shërbimit me gra, kanë qenë dhe janë zhargonit, që sipas ankuesve përdoret nga Shefja e Shërbimit, pa llogaritur xhestikulacionet hakërryese, e tone zëri shumë mbi normalen e komunikimit ndërnjerëzor.

Ankuesit shpjegojnë se, sapo M.I, u komandua Shefe Shërbimi, nën petkun e një reforme në metodika dhe protokollat e punës së shërbimit, vuri menjëherë në zbatim një metodikë personale të pakonsultuar. Kjo praktikë vazhdon ende të zbatohet pa asnjë rregullore të shkruar, as të afishuar dhe as të njoftuar, të gjithë anëtarëve të Shërbimit, por të urdhëruar verbalisht. Ankuesit deklarojnë se, të gjithë si kolektiv u munduan të përshtateshim me rregullat e shefes së re, por sipas tyre, prodhoheshin situata artificiale ngecje pune, ku fajtori ngelej jetim ose sipas preferencës së shefes mund t’i hidhej faji kujtdo që kishte hyrë në shënjestrën e inatit të saj, të shoqëruara me mbledhje diskriminuese, ku përtej tensioneve ndërnjerëzore, prodhoheshin edhe vërejtje me shkrim në drejtori, kryesisht për sektorin teknik.

Sipas ankuesve, situata kulmoi në korrik 2019, kur Shefja e Shërbimit i është drejtuar Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, me një ankesë sipas tyre të fabrikuar prej saj, kundër katër personave dhe konkretisht, dy ankuesve Dr.Sc. L.B e Dr.A.N, si dhe Dr.Sc.T.B e Dr.E.S. Pas reagimit që grupi i mësipërm i personave bëri në lidhje me këtë ankesë, është organizuar një mbledhje shërbimi, me praninë e Zv/Drejtoreshës së Përgjithshme Dr.As. A.S. Ankuesit shpjegojnë se, Drejtoria e QSUNT, ngriti një grup pune për verifikimin në atë kohë të pretendimeve të të dy palëve, të kryesuar nga Prof.A.D dhe Dr.A.P, si dhe personel administrativ i drejtorisë, të cilët përpiluan raportin për Drejtorin e QSUNT-së, z.Enkelejdi Joti, por ky raport nuk u zbardh kurrë dhe asgjë nuk ndryshoi në situatën e krijuar (periudha korrik-tetor 2019).

Ankuesit parashtrojnë se, kundër M.I, janë bërë disa ankime, një padi administrative e një grupi prej 5 vetësh, e cila u pasua nga e njëjta padi edhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor të Tiranë dhe se, dosja penale për “*Vjedhje dhe Fallsifikim dokumentacioni*” kundër saj, është akoma aktive

Ankuesit shprehen se, personat që kanë firmosur ankimet kundër M.I, kanë qenë subjekt presionesh të vazhdueshme prej 1 viti e 3 muajsh, të tilla si, presione verbale për t’u tërhequr nga ankesat, për të bërë deklarata se gjoja “*kanë nënshkruar në presion*”, ndërkohë që të gjithë edhe ata që nuk kanë firmosur ndajnë në heshtje të njëjtin qëndrim dhe vuajnë njësoj por në heshtje.

Ankuesit sqarojnë se, paditë administrative kundër M.I, ju drejtuan të gjitha institucioneve si Drejtoria e QSUNT, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, Platformës së Bashkëqeverisjes. Të gjitha këto institucione, vendosën të presin prononcimin e prokurorisë për këtë vepër penale. Ky mosreagim në kohën e duhur, ka sjellë si pasojë diskriminimin e vazhdueshëm nga M.I, në forma të ndryshme, te i gjithë stafi, por në veçanti tek 5 personat që e kanë kallëzuar atë në prokurori.

Ankuesit pretendojnë se, në mënyrë abuzive nga ana e Shefes së Shërbimit, ju hiqet dita e punës. Sipas tyre, ky fakt vërehet në listëprezencat e gjithë vitit 2020, me kulminacion në korrik të 2020, muaj në të cilin ankuesit pretendojnë se i'u janë hequr 12 ditë punë pa asnjë paralajmërim, duke qenë përditë në punë dhe duke realizuar biopsitë me firma dhe datat përkatëse.

Në ankesë, parashtrohet se, më datë 21 shtator 2020, Shefja e Shërbimit ka ndërprerë shpërndarjen e punës për ankuesin L.B, sipas këtij të fundit, pa asnjë shkak dhe asnjë argumentim, por listëprezencën e plotëson të plotë, si pasojë e paralajmërimit që ankuesi i dërgon kryelaborantes në *WhatsApp*, se firmëtarët e dokumentave të fallsifikuara mund të përfundojnë në prokurori. Ankuesi, shprehet Shefja e Shërbimit vazhdon të mos shpërndajë punë për të. Për këtë problematikë, ankuesi deklaron se, në datën 5 tetor 2020, ka paraqitur një ankesë, me email dhe në protokoll, drejtuar Drejtorit të QSUNT, që të ndërhyjë në cilësinë e eprorit, me fuqi ekzekutive dhe në cilësinë e punëdhënësit, për të zgjidhur këtë ngërç institucional. Drejtorit i është kërkuar edhe ngritja e një komisioni hetimi, në lidhje me shkeljet dhe falsifikimin e vazhdueshëm të listëprezencave. Ankuesi deklaron se muaji tetor 2020, ka vazhduar të plotësohet me mungesa, ndërkohë që përditë ai ka njoftuar kryelaboranten për prezencën e tij në punë, po ashtu edhe drejtorinë me anë të emaileve, ka patur dijeni për lokalizimin e tij brenda QSUNT.

Ankuesit parashtrojnë se, sjellja e Shefes së Shërbimit është materializuar edhe në ankesa në Dekanat e në Drejtori. Konkretisht, para 1 viti, në rastin e ankueses A.N, në një mbledhje shërbimi pas padive, është etiketuar publikisht nga M.I me fjalët "*Rrugace*". A.N sqaron se, në atë kohë i'u komunikua se, do të kishte qendrim nga Komisioni i Etikës së Fakultetit dhe QSUNT-së, por nuk ka patur asnjë qendrim.

A.N, parashtrohet në ankesë se, mjekët specializantë, sikundër është edhe ajo vetë, detyrohen të bëjnë punët e sekretarisë në shërbim, gjë që i pengon dhe u'a redukton në mbi 70 % kohën që ata duhet të shpenzojnë për mësimin dhe formimin e tyre profesional. Ajo pretendon se, disa herë ka patur ankesa nga këta mjekë në mbledhjet e shërbimit në lidhje me këtë fakt.

Ankuesit shprehen se, Drejtoria e QSUNT-së, në vend që të marrë masa për të ruajtur personelin, ka heshtur, duke toleruar shkeljet penale të Shefes së Shërbimit dhe duke goditur ankuesit.

Ankuesit pretendojnë se, Drejtoria e QSUNT-së, përdor standarte të shumëfishta edhe në pagesën e shërbimeve të tjera, puna e të cilëve u dëmtua nga tërmeti, siç është dermatologjia apo shërbimet e tjera që kaluan gati në gjumë prej pandemisë, siç janë reumatologjia, alergologjia. Sipas ankuesve, mjekët në këto shërbime paguhën çdo ditë edhe pse nuk shkojnë në punë, sepse punojnë me turne, në kushte minimaliste, ndërkohë që ankuesi, i cili paraqitet çdo ditë në punë dhe pret që t'i jepen biopsi për zgjidhje, penalizohet.

Sipas ankuesve, ankesë të të njëjtit lloj, në rrafshin komunikativ kundër M.I është bërë edhe nga mjekë të shërbimeve të tjera, të nivelit titullar epror, në Komisionin e Etikës së QSUNT-së, si

dhe në Urdhrin e Mjekut, siç është ankesa e bërë nga Prof/Asc H.N, Drejtor i Spitalit Onkologjik, ankesë e cila është në proces vlerësimi.

Në përfundim ankuesit kërkojnë nga Komisioneri:

- Ndërprerjen e menjëhershme dhe urgjente të diskriminimit nga ana e M.I, Shefe e Shërbimit dhe Drejtorisë së QSUNT-së, me anë të listëprezencave, që reperkutohet në pagën mujore të mjekëve.
- Ngritjen e një Komisioni Spitalor Ekspertësh, për verifikimin e listëprezencave problematike të hershme dhe të vonshme të Shërbimit të Anatomisë-Patologjike, që nga fillimi i mandatit të M.I.
- Rimbursimin e dëmeve financiare ndaj ankuesve.
- Verifikimin e raportit të punës të ngritur nga drejtori, në periudhën korrik 2019, që nuk u zbardh kurrë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, **bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.**”

Në referencë të kësaj dispozite ligjore, rezulton se shkaqet e pretenduar nga ankuesit, *bindjet fetare, gjendja arsimore, gjendja martesore, përkatësia në një grup të veçantë*, janë shkaqet të mbrojtura, të parashikuara shprehimisht nga ligji, ndërkohë që nga ana tjetër, lista e shkaqeve të mbrojtura të cituara shprehimisht në këtë nen, është një listë orientuese dhe jo shteruese.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminim garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë*, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të ligjit. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1641/2 prot., datë 18.12.2020, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr. 1641/3 prot., datë 24.12.2020, Komisioneri ka kërkuar saktësimin e shkaqeve të pretenduara të diskriminimit për secilin prej ankuesve në mënyrë individuale, si dhe shpjegimet përkatëse të ankuesve lidhur me shkaqet e pretenduara.

Ndërkohë që ankesa ishte në shqyrtim, Komisioneri është njoftuar nga ankuesi L.B, se me shkresën nr. 2828/5 prot., datë 24.12.2020, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka njoftuar ankuesin për zgjidhjen e kontratës së punës në datën 31.12.2020.

3. Me shkresën nr. 1844 prot., datë 28.12.2020 dhe bazuar në nenin 15, pika 2, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “***1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.***”, Komisioneri, ka kërkuar nga QSUNT, marrjen e masave për të siguruar të drejtën e ankuesit për të vazhduar punën.
4. Në datën 06.01.2021⁴, ankuesja A.N, ka saktësuar se shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ana e saj janë gjendja arsimore, kjo pasi ankuesja ka statusin si mjeke specializante dhe përkatësia në një grup të veçantë, referuar shpjegimeve të dhëna në ankesë.
5. Në datën 07.01.2021⁵, ankuesi L.B, ka saktësuar se shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ana e tij janë bindjet fetare, gjendja martesore dhe përkatësia në një grup të veçantë, duke ju referuar të njëjtave shpjegime të dhëna në ankesë.
6. Me shkresën nr. 124 prot., datë 08.01.2020⁶, QSUNT, ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar qëndrimin e saj, si më poshtë:

⁴ Parashtrimet e ankueses janë dërguar në mënyrë elektronike (me *email*).

⁵ Parashtrimet e ankuesit janë dërguar në mënyrë elektronike (me *email*).

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 38 prot., datë 08.01.2021.

QSUNT, parashtron se, nuk ka asnjë ankesë të depozituar, ku të përmendet përkatësia fetare, statusi social apo përkatësia në një grup të veçantë, të mjekut pedagog L.B dhe mjekut specialist A.N. Lidhur me problematikën e ngritur nga disa punonjës të Shërbimit të Laboratorit të Anatomisë-Patologjike, mbi pretendimet e tyre lidhur me falsifikimin dhe abuzimin me detyrën, QSUNT, shpjegon se, ankesa nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga ana e saj, për shkak të mungesës së kompetencave dhe për shkak se kjo çështje i është drejtuar nga vetë pretenduesit, një organi më të lartë dhe kompetent për zgjidhjen e çështjes.

QSUNT, informon se, M.I, është emëruar Shefe e Shërbimit, në vijim të konkursit të zhvilluar për këtë pozicion dhe emërimi i saj është miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Bazuar në kontratën e lidhur për këtë pozicion, detyrat e Shefit të Shërbimit janë si vijon : “ - *Të mbikëqyr zbatimin e disiplinës në punë nga personeli mjekësor, administrativ apo ndihmës i Shërbimit dhe rregullin në shërbim nga ana e pacientëve dhe familjarët e tyre.-Organizon punën në Shërbim (shtrimet, konsultat ambulatore/multidisiplinare, urgjencat, rojet, etj) dhe ndan detyrat tek stafi në varësi.*

Ndërkohë në zbatim të Rregullores së funksionimit të QSUNT, miratuar në vitin 2015, janë të mirëpërcaktuara detyrat e Shefit të Shërbimit, ku midis tyre përcaktohet se: “- *Drejton mbledhjen e mëngjesit, ku raporton mjeku i rojes mbi shtrimet e kryera në ditën pararendëse dhe gjithçka ka ndodhur në shërbim, verifikon prezencën e personelit të lartë dhe përcakton detyrat e ditës. - Kontrollon mbajtjen e rregullt të dokumentacionit dhe dërgimin e evidencave dhe informacioneve të kërkuara nga Drejtoria/Poli i Administrimit të Integruar. - Miraton listën e lejeve të zakonshme të jekëve në Shërbimin e tij. - Mban përgjegjësi për hartimin e rregullores së funksionimit brenda Shërbimit Mjekësor që drejton dhe monitoron zbatimin e saj pas miratimit nga strukturat përkatëse.*”

Lidhur me pretendimin e listëprezencave, QSUNT, shpjegon se, ankuesit kanë rezultuar disa herë me mungesë dhe se A.N, e cila është me statusin specialist, ka detyrimin të paraqitet në ambientet e QSUNT, në ndjekje të kurrikulave mësimore. Ndërsa, L.B, bazuar në kontratën e tij të shërbimit, nënshkruar në 2018, neni 3, ku parashikohet detyrimi për t'u paraqitur në punë, rezulton në shkelje pasi ka mungesa të vazhdueshme dhe pa arsye, referuar listëprezencave të shërbimit. Në 2018 (me shkresën nr.3400/1 prot., datë 16.07.2018), L.B i është tërhequr vëmendje nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore⁷, për mosprezencën në punë, gjë e cila është raportuar nga shefi i shërbimit. Po kështu, gjatë vitit 2020, përkatësisht në periudhat 1-3 korrik, 13-17 korrik dhe 27-30 korrik, mjeku ka rezultuar sërish me mungesë pa arsye në listëprezencën mujore. Mungesa të përsëritura dhe pa arsye ka patur edhe për periudhën 01-30 tetor dhe 01-30 nëntor, kjo gjë edhe pas shkresës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DBNj), (shkresa nr. 2828/4 prot., datë 27.10.2020) ku është bërë me dije se shefi i shërbimit ka detyrimin të bëjë verifikimin e prezencës së personelit mjekësor.

⁷ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DBNj.

QSUNT, shpjegon se, me email datë 05.10.2020, L.B ka referuar se: “ Nga koha e tërmetit të 2019, vendodhja ime e punës është në katedrën e Anatomisë Patologjike çdo ditë. Duke patur parasysh situatën pandemike të Covid çdo marrëdhënie shërbimi është kryer dhe do ta kryer nëpërmjet kryelaborantes O.R si dhe specializantit përkatës mentor i të cilit jam.” Sa më sipër, L.B ka pohuar se nuk paraqitej në vendin e tij të punës (Katedra e Anatomisë Patologjike nuk është pjesë e Laboratorit të QSUNT), në zbatim të kontratës së shërbimit, e për pasojë prezenca e tij në listëprezenca është pasqyruar mungesë. Nga pohimet e L.B ai ka mbajtur marrëdhënie me kryelaboranten, gjë e cila bie ndesh me hierarkinë e QSUNT, pasi kryelaborantja nuk ka kompetencë për mbulimin e detyrave dhe përgjegjësi të shefit të shërbimit. Veprimet janë kryer në vazhdimësi nga ana e mjekut, edhe pas komunikimeve verbale me drejtuesit dhe shkresës së DBNj, me nr. 2828/4, datë 27.10.2020, ku i është bërë me dije se, shefi i shërbimit ka detyrimin të përcaktojë detyrat e ditës së mjekëve.

QSUNT, sqaron më tej se, me shkresën nr. nr.2828/3prot, datë 24.10.2020, L.B, i janë bërë me dije problematikat në komunikim, mosprezencë, refuzimin e detyrave, braktisjen e pacientëve në mënyrë të përsëritur, të cilat sipas QSUNT, rezultojnë edhe në vlerësimin e performancës vjetore me nr.2574/52 datë 13.08.2019. Në këtë vlerësim të performancës, nga DBNJ është rikërkuar nga mjeku, zbatimimi i kushteve të kontratës.

Bazuar në kontratën që L.B ka me QSUNT, pra kontratës së shërbimit, statusi i tij nuk është punëdhënës-punëmarrës, por ajo e ofruesit të shërbimit dhe përfituesit të shërbimit. Sipas QSUNT, kontrata e shërbimit nuk i referohet Kodit të Punës për zgjidhjen e saj apo trajtimin e saj ligjor dhe L.B nuk mban statusin e punëmarrësit në QSUNT, pasi këtë status ai e gëzon në Fakultetin e Mjekësisë Tiranë.

Në lidhje me kërkesën për të vendosur në dispozicion informacion mbi numrin e biopsive të realizuara dhe personat që i kishin realizuar ato, QSUNT nuk vendosi në dispozicion informacionin e kërkuar, por sqaron se, biopsitë variojnë në varësi të indikacioneve nga shërbimet mjekësore dhe u shpërndahen mjekëve në mbledhjen e mëngjesit.

Në lidhje me kërkesën e Komisionerit për të vendosur në dispozicion dokumentacionin e hartuar nga grupi i punës i ngritur në 2019, QSUNT nuk e vendosi në dispozicion, duke sqaruar se dokumentacioni në fjalë është jashtë objektit të ankesës dhe është një material për menaxhim të brendshëm.

7. Me datë 11.01.2020⁸, M.I, ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar qëndrimin e saj, si më poshtë:

Sipas M.I, pretendimet e ankuesve janë devijime nga realiteti konkret dhe e vërteta. Fjalët e përdorura në ankesë, me etiketime të pandershme dhe të mbushura me pohime të rreme, janë

⁸ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 60 prot., datë 11.01.2021.

fyerje ndaj shefit të shërbimit dhe çënojnë dinjitetin jo vetëm si koleg por mbi të gjitha të moralit njerëzor. Për rrjedhojë, gjuha e përdorur është një gjuhë urrejtje.

M.I prapëson se në lidhje me mënyrën e trajtimit dhe hetimit të çështjes, Komisioneri ka tejkualuar objektin e ankesës, (*referohet tek kërkesa për informacion që Komisioneri ka bërë në lidhje me ankesa të tjera drejtuar kundër M.I*) koha e hetimit gjithashtu nuk përputhet me kohën e diskriminimit të përcaktuar nga ankuesi. Sipas M.I, Komisioneri, nuk merret me faktin por me personin, gjë që duket qartë sipas saj nga kërkesat për informacion të parashtruara nga Komisioneri, duke pretenduar se ky i fundit, më parë duhet të ishte informuar mbi të vërtetën nga vetë ajo.

Pas tërmetit të nëntorit 2019 dhe daljes së godinës jashtë përdorimit , si dhe pas transferimit në ambientet e reja, të cilat morën kohën e tyre, M.I shprehet se, Shërbimi i Anatomisë Patologjike, përfshirë këtu të gjithë stafin (mjek, laborant e sanitar) dhe mjetet ndihmëse, aparaturat laboratorike, arshiva dhe gjithçka tjetër që është në shërbim të punës së përditshme, është zhvendosur dhe kryen aktivitetin e tij diagnostik dhe laboratorik, në ambjentet e Spitalit Onkologjik. I vetmi mjek që nuk paraqitet në Shërbimin e Anatomisë Patologjike, pranë kësaj godine ku është vendi i punës, prej një kohe të gjatë është mjeku Dr.L.B, i cili e pohon dhe e pranon edhe vetë këtë fakt në ankesë. Për këtë fakt, mjekut me shkresën nr.2828/4 prot., datë 27.10.2020 i është tërhequr vëmendje për shkelje të detyrave funksionale nga ana e Drejtorisë së QSUNT. Ai vazhdon edhe sot të mos paraqitet në vendin e punës në Shërbimin e Anatomisë Patologjike, në ambjentet e Spitalit Onkologjik, duke sjellë në vëmendje se Katedra e Anatomisë Patologjike nuk është pjesë e Laboratorit të QSUNT. M.I më tej sqaron se puna nuk vazhdon me turne javore për mjekët, siç pretendon ankuesi, por vijon normalisht.

M.I shpjegon se, mosprezenca e L.B në shërbim është e hershme dhe ky fakt është evidentuar në muajin shkurt 2020 nga një kontroll i befasishëm i drejtorisë më datë 25.02.2019, i cili kryhet rradhë nëpër shërbime, me qëllim disiplinimin e punës, ku të dy mjekët ankues nuk janë gjetur në vendin e punës dhe ju është hequr dita e punës.

Mjeku nuk mund të përcaktojë vetë vendin se ku do të punojë, kur nuk ka asnjë ligj, rregullore ose urdhër të drejtorisë. Vendi i punës është një vend i hapur dhe publik, jo i fshehur nga sytë e kolegëve. Ankuesi nuk ka asnjë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e tij mjekësor përtej vendit të punës, që gjendet në Shërbimin e Anatomisë Patologjike dhe në mungesë bashkëpunimi me shefin dhe stafin e shërbimit. Pavarësisht këtij fakti, M.I shprehet se ankuesi është toleruar më shumë se kushdo tjetër, duke e mirëkuptuar në kohë pandemie e në punë me turne.

Për më shumë se një vit, M.I shprehet se, mjeku nuk ka asnjë kontakt fizik dhe verbal me shefin e shërbimit, fakt që pohon edhe vetë në emailin e datës 05.10.2020 ora 11:25, dërguar drejtorisë,

ku pohon se nga koha e tërmetit 2019 çdo marrëdhënie me shërbimin e ka kryer dhe do të vazhdojë ta kryejë nëpërmjet kryelaborantes dhe specializantit përkatës, mentor i të cilit është.

Me kontakte individuale ose grupe të vogla me drejtuesin e shërbimit çdo ditë në mëngjes, verifikohet prezenca e personelit të lartë (mjekët), dhe në bazë të saj ndahen detyrat e ditës, sipas rregullores por edhe traditës shumë vjeçare. Në kushtet e mosprezencës konkrete në shërbim si rrjedhojë dhe të mungesës së terrenit të zgjidhjes së problematikave që hasen në punë, mjekut nuk i janë përcaktuar detyrat e ditës, sipas rregullores.

Përveç problematikave të mësipërme, M.I parashtron se mjeku ka refuzuar disa herë të kryejë detyrat e ngarkuara nga drejtuesi i shërbimit, të cilat janë bërë prezent në vazhdimësi në drejtori. Rasti i fundit është moszgjidhja e biopsisë së pacientit 1992/20, e muajit korrik 2020. Trajtimi i këtij rasti është refuzuar dhe braktisur nga mjeku L.B, për ta përfunduar dhe për ta nxjerrë në konsultë të përgjithshme pranë shërbimit, sipas rregullores së QSUNT (pika 4 dhe pika 13) si dhe rregullores së brendshme në raste të vështira (pika2b). Pra ky rast nuk u zgjidh kurrë prej mjekut dhe nuk u paraqit kurrë për llogaridhënie, duke e lënë rastin në mëshirë të fatit dhe rrjedhimisht edhe pacientin. Ndërkohë që raste të tilla mjeku i zgjidh vazhdimisht në struktura private. Për këtë rast, M.I shprehet se ka njoftuar me shkresë drejtorinë.

Pikërisht për rastin e mësipërm, M.I shpjegon se përgjatë muajit korrik në mënyrë të vazhdueshme dhe në komunikim me drejtorinë, i ka kërkuar mjekut dhe specializantes, të paraqiten në shërbim për të referuar rastin në konsultën e përgjithshme, si dhe për të marrë shpjegime mbi arsyet e vonesës dhe moszgjidhjen e rastit që nga muaji maj. Ankuesit jo vetëm që kanë refuzuar të paraqiten në shërbim, por me indeferentizëm nuk kanë dhënë asnjë përgjigje për zgjidhjen e biopsisë. Sipas M.I, për këto kohë refuzimi, mjeku dhe specializantja nuk janë paguar.

Me kalimin e muajve të vështirë të pandemisë (reduktimit të stafit, punës me turne) dhe pushimeve të verës, M.I shprehet se, ka pritur që mjeku në muajt në vazhdim të reflektojë kundrejt prezencës në shërbim si dhe angazhimit në punë dhe në marrëdhënien me drejtuesin e tij, periudhë kjo që përkon duke filluar nga muaji tetor deri tani. M.I sqaron se, gjatë muajit tetor 2020, detyruar nga rrethanat dhe për transparencë, shërbimi disponon një listë me emrat e stafit dhe kryesisht për mjekët me firmat e tyre për prezencën në shërbim dhe në punë. I vetmi mjek që sipas saj, nuk është paraqitur në punë si nga verifikimi personal i M.I ashtu edhe nga mungesa e firmës është mjeku, në antitezë me specializanten ankuese, e cila vijon rregullisht të paraqitet si dhe të firmosë prezencën e saj.

Për sa i përket, pretendimit lidhur me përkatësinë fetare dhe atë martesore, M.I në radhë të parë thekson se, për më shumë se një vit nuk ka asnjë kontakt fizik apo verbal të përditshëm me dy mjekët bashkëshortë, në rastin e ankuesit për arsyet e cituara më sipër dhe për bashkëshorten e

ankuesit, për shkak të dorëheqjes së saj nga nëntori 2019, për shkak të koncesionit të laboratorëve. M.I shprehet se ajo nuk ka asnjë interes se çfarë besimi ka ankuesi apo kushdo tjetër, pasi besimi është çështje personale e çdo kujt. Shteti është laik dhe qendra e punës është një vend i tillë dhe se nuk shkojmë në punë për fenë, por punën, shprehet M.I. Më tej, M.I deklaron se, pretendimin mbi gjendjen martesore, e konsideron të pakuptimtë, pasi për më shumë se një vit ajo nuk di asnjë gje rreth tyre.

M.I, prapëson se, pretendimet në lidhje me xhestikulacionet apo tonin e saj të zërit, duke hiperbolizuar mbi to, përbëjnë jo vetëm privim nga të drejtat e saj njerëzore, por edhe një llojurvejimi dhe përndjekje ndaj saj. M.I, deklaron se ajo ka ndërtuar personalitetin e saj publik dhe profesional, me punë, me meritë dhe ndershëmëri dhe jo duke diskriminuar njerëz, por duke qenë bashkëpunuese me kolegët. M.I shprehet se, ka marrëdhënie shumë të mira me të gjithë mjekët e shërbimit që drejton, me të cilët punon prej vitesh, duke përfshirë edhe mjekë të tjerë që kanë dalë në pension, por edhe personalitete të tjera të mjekësisë.

8. Me shkresën nr. 61, datë 11.01.2021, pranë Komisionerit është administruar një dokument, i nënshkruar nga staf mjekësor, laborant dhe mjekë specializantë, në të cilin, ata parashtrajnë para Komisionerit, opinionin e tyre të përbashkët në lidhje me punën në shërbimin e anatomisë patologjike, duke u shprehur, ndër të tjera se: *“...rritja sasimore e punës është konvertimi më i mirë dhe treguesi më domethënës i vlerësimit të punës dhe vizionit tonë përtej mureve të shërbimit. Ndërkohë në rrafshin cilësor kryhen më shumë testimet imunohistokimike si dhe testimet e reja të futura së fundmi.Këta tregues flasin se tashmë shërbimi gjendet në stad tjetër referuar viteve më parë. Mënyra e re e organizimit është rezultative dhe e dobishme. Për çdo biopsi janë përgjegjës dy mjekë dhe dy laborantë....., kjo bën të mundur që njëri mjek kontrollon tjetrin duke shmangur gabimin diagnostik dhe për më tej edhe korrigjimin e tij.Të gjithë mjekët e shërbimit tonë (me ndonjë përjashtim) mendojmë se shërbimi ka një organizim të punës së përditshme efektiv si dhe një funksionim të aktiviteteve diagnostike, që i përgjigjen vizionit tonë të përbashkët për një shërbim cilësor në dobi të pacientit. Çdokush brenda shërbimit tonë që ka mendim ndryshe se shërbimi ynë ka ulur performancën, do të thotë se nuk ka një qëllim të dobishëm për punën dhe kolegët, si dhe nuk i përshtatet realitetit konkret që ne e prekim çdo ditë. Çdo përpjekje për t’u rikthyer prapa, do të thotë një regres në kohët e errëta të kaosit dhe cënon sakrificën e çdo mjeku që me korrektësi dhe seriozitet profesional lë diçka nga vetja në dëm të shëndetit të tij personal.... Në respekt të vështirësisë së punës tonë diagnostike, por edhe të rëndësisë e seriozitetit të saj, çdokush që nuk e sheh dhe vlerëson atë na fyen në përpjekjen tonë si grup i dedikuar me përkushtim në këto tre vite për ta çuar shërbimin përpara.”*
9. Me shkresën nr. 210 prot., datë 01.02.2021, janë administruar prapësimet e ankuesve, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

- *Për mosparaqitjen në vendin e punës dhe listëprezencën në punë.*

Ankuesi L.B, ka njoftuar me e-mail zyrtar se, vendndodhja e tij e punës që nga koha e tërmetit 2019 është Katedra e Anatomisë Patologjike, çdo ditë. Referuar kontratës së punës, mjeku është pedagog pranë Fakultetit të Mjekësisë dhe ofron shërbimet e tij dhe pranë QSUNT. Rezulton e papërcaktuar në mënyrë eksplicite se cili është vendi i punës në aspektin fizik. Kontrata dhe aneks kontrata e lidh detyrimin e mjekut me realizimin e punës objekt kontrate. Rëndësi ka realizimi i biopsive dhe jo vendi ku ato realizohen, pasi në rastin konkret jemi përpara një qendre universitare, ku Fakulteti i Mjekësisë është i integruar brenda vetë qendrës. Shefja e Shërbimit në vitin 2020, dhe kryesisht në muajin tetor 2020 e në vazhdim, mban listëprezencën në punë, duke pretenduar se ankuesi nuk është paraqitur në punë, ndërkohë që ai ka njoftuar vendndodhjen e tij brenda QSUNT, me email zyrtar.

QSUNT përdor standarte të dyfishta në raport me kolegë të tjerë pedagog të cilët punojnë pranë katedrave të tyre. QSUNT përdor standart të dyfishtë edhe me pagesën e shërbimeve të tjera, godinat e të cilave u dëmtuan nga tërmeti (si dermatologjia,) apo shërbime të tjera si reumatologjia, alergologjia, ku për shkak të pandemisë mjekët punojnë me turne, por paguhen përditë.

Në lidhje me ankuesen A.N, ajo në çdo rast është paraqitur pranë ambienteve të QSUNT, pranë Katedrës së Anatomisë Patologjike, aty ku doktori i saj mentor ka ushtruar punën. Marrja e mungesave përmes listëprezencave të mbajtura në shërbimin e anatomisë patologjike, duke përcaktuar se ajo nuk është paraqitur, e vendos atë në kushte diskriminimi të hapur me kolegët e saj, sa kohë që të gjithë kolegët specializantë asistohen dhe punojnë pranë mjekut që i ka në patronazh.

Në lidhje me shkresën e vitit nr. 3400/1 prot., datë 16.07.2018, për tëheqje vëmendje për mosparaqitje në punë, ankuesi L.B, shprehet se nuk ka marrë ndonjëherë dijeni.

Sipas ankuesve, prezencën e tyre gjatë vitit 2020, është lehtësisht e verifikueshme nga volumet e punës që ata kanë kryer dhe kolegët dëshmitarë që ata kanë bashkëpunuar. Nga data 05.10.2020 ankuesi L.B, ka njoftuar drejtorinë e QSNUT-së, për ndërprerjen e paprecedentë të punës dhe mungesat që i viheshin në vazhdimësi, por nuk kanë marrë zgjidhje. Në vend të zgjidhjes së problemit, kanë marrë shkresën nr.2828/4 prot, datë 27.10.2010, e cila është nënshkruar nga drejtoresha e burimeve njerëzore, sipas të cilës ankuesit duhet t'i nënshtrohen rregullave ditore të pashkruara të shërbimit, ndërkohë që Laboratori i anatomisë-patologjike është nën kompetencën e Dr.Sc.A.S, e cila është anashkaluar qëllimisht, pasi kjo e fundit i ka verifikuar shkeljet e M.I gjatë verës së 2019, kur stafi prej 10 vetë, kërkuan me firmë që të përmirësohet metodika e punës.

- *Në lidhje me diskriminim për shkak të përkatësisë bashkëshortore (gjendja martesore)*

Sa i përket statusit social, ka dokumenta në drejtori nga shefja e shërbimit dhe konkretisht shkresa datë 10.09.2019 ku citohet “... ka patur raste edhe 9 muaj nga të dy mjekët bashkëshortë”. Ky dokument nuk ka ngjallur as reagimin më të vogël nga ana e drejtorisë. Shprehje të tjera të përdorura nga shefja “...përtej sabotimit që i bëjnë dy mjekët bashkëshortë dhe laborantja e tyre personale në sektorin privat të mbështetur edhe nga elementë të tjerë brenda drejtorisë...” Përdorimi i gjuhës dhe shprehjeve të mësipërme, konsiderohet diskriminues dhe ankuesi L.B shprehet se drejtorja nuk ka marrë asnjë masë.

Ankuesja A.N, është ankuar me shkrim në vitin 2019, ndaj fyerjes së bërë nga shefja e shërbimit, e cila i është drejtuar me fjalët “rrugaçe”. Për këtë ankesë, përveç një takimi sqarues me Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, nuk është ndërmarrë asnjë masë.

- *Në lidhje me standartin e dyfishtë për listëprezencat.*

Drejtorja e QSUNT nuk ka verifikuar shkeljet e referuara nga kolektivi prej 5 vetësh, në lidhje me pagesën e dy mjekëve të cilët ndodhen në Gjermani, por figurojnë në listëprezencat e mbajtura nga shefja e shërbimit dhe paguhen, me justifikimin se po hetohet çështja në prokurori.

- *Në lidhje me pretendimin se L.B nuk ka respektuar nenin 3 të kontratës që bën fjalë për kohëzgjatjen e punës.*

Në çdo rast ankuesi shprehet se, ka përmbushur këtë detyrim kontraktor, pasi ai ka kryer punën si pedagog dhe ka njoftuar mbi vendin e punës në katedër për realizimin e detyrave në lidhje me shërbimin e anatomisë patologjike, sa kohë ndërtesa e këtij shërbimi ka qenë jofunksionale që prej tërmetit 2019. Ankuesi shprehet se, ka njoftuar drejtuesin e QSUNT me e-mail në datën 05.10.2020, mbi faktin se shefja e shërbimit, M.I, nuk e përfshinte në punë. Ankuesi pretendon se, është diskriminuar duke u trajtuar ndryshe nga kolegët e tjerë, pasi nuk i është ndarë punë edhe pse në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar me insistim të përfshihet në punë.

- *Në lidhje me statusin e ankuesit L.B me Kodin e Punës.*

Kontrata e lidhur midis ankuesit dhe QSUNT në nenin 1 të saj që bën fjalë për bazën ligjore, përcakton qartë se kjo kontratë është hartuar dhe bazohet në Kodin e Punës.

- *Në lidhje me numrin e biopsive të realizuara në Shërbimin e Anatomisë Patologjike dhe personat që i kanë kryer ato.*

Ankuesit shprehen se ky është një informacion i rëndësishëm në kuadër të diskriminimit profesional që ka përjetuar gjatë punës së tij në këtë shërbim. Ankuesi në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar që t'i ndahet punë, por nuk është dëgjuar dhe është proceduar administrativisht për mospërmbushje të punës dhe mosparaqitje në vendin e punës.

Ankuesi shprehet se, ai është kërkuar shkencor, e si i tillë nuk mund të kufizohet në punë burokratike. Ai ka dhe duhet të ketë lirinë për të lëvruar punën si pedagog dhe kërkimin

shkencor. Angazhimi i tij në katedrën ku jep mësim nuk e zhbën kapacitetin e tij për të realizuar detyrat në Shërbimin e Anatomisë Patologjike.

10. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁹, të ndryshuar dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, në datën 11.03.2021 , Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesmarrjen e ankuesve L.B dhe A.N dhe përfaqësuesit të tyre Av. A.L, me Nr.Licence 6925, QSUNT-së, përfaqësuar nga z.Redon Guma, sipas autorizimit nr.801/1 prot., datë 11/03/2021. Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të M.I, Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, pranë QSUNT-së. M.I me e-mailin e datës 11.3.2021, ora 11.19, njoftoi në postën elektronike të institucionit të Komisionerit: info@kmd.al, se e kishte të pamundur pjesmarrjen në seancë, me pretendimin se zarfin me njoftimin e seancës dëgjimore të dërguar nga Komisioneri e kishte gjetur në zyrën e saj në datën 11.03.2021. Orari i seancës dëgjimore ishte i pamundur për të jo vetëm fizikisht, por edhe për t’u përgatitur. Ky njoftim në lidhje me pamundësinë për të marrë pjesë i është komunikuar Komisionerit, pasi seanca dëgjimore kishte filluar.

Nga aktet e administruara në dosje rezulton se, njoftimi i seancës dëgjimore për M.I, është realizuar në të njëjtën adresë, pra vendi i saj i punës në QSUNT, sikundër korrespondenca tjetër e mbajtur me subjektin. Nga ana e shërbimit postar është dorëzuar lajmërim marrja, sipas të cilës rezulton se zarfi me njoftimin e seancës dëgjimore është dorëzuar në adresë, në datë 9.3.2021. Në këto kushte njoftimi i palës u konsiderua i realizuar dhe seanca u zhvillua në prezencë të palëve që ishin paraqitur.

Nga ana tjetër M.I në njoftimin e saj për pamundësinë e pjesmarrjes në seancë dëgjimore, pranon faktin se e ka marrë njoftimin, por nuk provon pretendimin se marrja e njoftimit prej saj është në datë 11/3.2021, pra në të njëjtën ditë me datën e seancës.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesit i qëndruan të njëjtave parashtrimeve. Përfaqësuesi i QSUNT deklaroi se nuk kishte shpjegime shtesë dhe se i qëndronte shpjegimeve të depozituara me shkresën nr. 124 prot., datë 8.01.2021.

QSUNT, nuk depozitoi gjatë seancës dëgjimore informacionin dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar nga Komisioneri me shkresën për njoftimin e seancës dëgjimore dhe i’u la detyrë dërgimi i të gjithë informacionit të kërkuar brenda datës 19.03.2021.

⁹ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fion palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

11. Me shkresën nr.801/3 prot., datë 18.03.2021¹⁰, të dërguar në vijim të kërkesës për plotësimin e informacionit të bërë nga Komisioneri, QSUNT , ndër të tjera sqaron se:

Plotësimi dhe përpilimi i listë prezencave bëhet referuar urdhrin të brendshëm nr.271/2014. Në lidhje me shërbimin e Reumatologjisë, Alergologjisë dhe Dermatologjisë në asnjë moment nuk kanë ndalur së ofruari shërbimin mjekësor ndaj pacientëve pasi është fakt se çdo ditë në QSUNT janë ofruar konsulta me mjekë specialist. Në lidhje me shërbimin e Dermatologjisë, QSUNT shpjegon se ky shërbim pas tërmetit të muajit nëntor 2019 është vendosur në PAI Infektiv. Gjatë pandemisë këto shërbime janë vendosur dhe ofrojnë shërbimin në PAI Francez. QSUNT shprehet se për të tre këto shërbime nuk disponojnë listë prezencave ku referohen mungesa të mjekëve për shkak të tërmetit ose pandemisë. Në lidhje me ankuesin L.B, QSUNT shprehet se, ai është në pozicionin mjek pedagog prej vitit 2005 dhe se në dosjen e tij gjendet vetëm kopje vlerësimi për periudhën janar-korrik 2019. Ndërsa për ankuesen A.N, QSUNT shprehet se nuk disponojnë kopje të kontratës që ankuesja ka nënshkruar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por vetëm kopje të deklaratës së ankueses lidhur me faktin që ajo ka një kontratë të lidhur me MSHMS.

12. Në datë 19.03.2021, M.I ka dërguar me *e-mail*, një informacion, ku ndër të tjera parashtrohet se:

Në protokollet e mbledhjeve të Shërbimit të Anatomisë Patologjike evidentohen mungesat e përsëritura dhe të pajustificuara të mjekut L.B. Sipas M.I, mjeku L.B ka braktisur biopsi të pacientëve me kancer duke rrezikuar seriozisht shëndetin e tyre, pa asnjë justifikim dhe pa i paraqitur në konsultën e përgjithshme të shërbimit, si organi që zgjidh dhe drejton të gjitha rastet problematike.

M.I shpjegon se, shpërndarja e punës bëhet çdo ditë nga shefi i shërbimit në mbledhjen e mëngjesit. Rregulli i shpërndarjes së punës bazohet në volumin e punës dhe ngarkesën e saj, numrin e mjekëve në dispozicion, eksperiencën dhe përvojën mjekësore dhe natyrisht fushat në të cilat kanë patur eksperiencë. Sipas shpjegimeve të M.I, sistemi arsimor në vendin tonë në fushën e mjekësisë nuk përgatit dhe nuk diplomon specialistë të anatomisë patologjike në subspecializime dhe nuk ka mjekë të rekrutuar në subspecializime. Ka një përvojë të krijuar e cila në disa raste merret në konsideratë, por volumi i punës dhe nevojat e pacientit janë përcaktuese. M.I shpjegon se, mjekes T.B, e cila tashmë nuk është më pjesë e shërbimit, krahas biopsive të tjera i shpërndaheshin biopsitë e neurokirurgjisë, si më me eksperiencë pune në këtë fushë. Këto biopsi, tashmë zgjidhen nga mjekë të tjerë, si në rastin konkret shefi i shërbimit, si mjeku me përvojën më të madhe në punë dhe atë akademike. Në spitale private, mjekët anatomo patologë punojnë në numër të reduktuar 2-3 vetë dhe ushtrojnë specialitetin e tyre sipas rasteve dhe jo sipas subspecialiteteve në ndihmë të nevojave të spitalit dhe jetës së pacientit.

¹⁰ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.416/1 prot., datë 24.03.2021.

13. Me shkresën nr. 416/2 prot., datë 2/4/2021, Komisioneri kërkoi informacion nga M.I, për pretendimet e ankueses A.N, në lidhje me sjelljen dhe përdorimin e fjalorit shqetësues ndaj saj për shkak të statusit të saj si specializante si dhe trajtimin e specializantëve në shërbimin e anatomisë patologjike. Me shkresën nr. nr. 416/3 prot., datë 2/4/2021, Komisioneri kërkoi informacion mbi masat e marra nga QSUNT, për pretendimet e ankueses A.N kundrejt M.I, në lidhje me sjelljen dhe përdorimin e fjalorit shqetësues nga kjo e fundit kundrejt ankueses, për shkak të statusit të saj si specializante, si dhe trajtimin e specializantëve në shërbimin e anatomisë patologjike.
14. Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.801/5 prot., datë 09.04.2021¹¹, QSUNT ndër të tjera sqaron se: *“....Pasi ankuesja ka bërë me dije drejtorinë e përgjithshme për shqetësimin e saj në lidhje me shefen e shërbimit kundrejt saj, menjëherë drejtoria e burimeve njerëzore, ka organizuar një takim për të dëgjuar dhe shpjeguar situatën. Pra, ky takim ka shërbyer për të zgjidhur problematikën dhe për të vijuar normalisht punën në laboratorin e anatomisë patologjike..... Shefi i Shërbimit ka detyrimin dhe të drejtën të organizojë punën në laborator dhe të shpërndajë detyrat në mënyrë që puna të kryhet me efikasitet dhe cilësi. Sipas rregullores së brendshme të QSUNT-së, specializanti ka të njëjtat përgjegjësi si mjeku i shërbimit, pra përgjigjet me bashkëpunim dhe përkushtim detyrave të lëna nga eprori.”*
15. Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, në datën 12.4.2021¹², M.I, ka kthyer përgjigje duke dhënë sqarimet vijuese:

Pretendimet e ankueses A.N, janë totalisht të pavërteta. A.N ashtu dhe L.B kanë braktisur vendin e punës, një akt ky i dënueshëm duke marrë në konsideratë peshën dhe rëndësinë e institucionit ku punojnë dhe shërbimin që ofrojnë.

M.I shprehet se, A.N së bashku me mentorin e saj nuk mund të ndërtojnë një stacion ku të dojë ajo, për të kryer detyrat funksionale, larg godinës së shërbimit ku ndodhet laboratori dhe të gjitha instrumentat dhe pajisjet e nevojshme për të realizuar detyrën funksionale. A.N së bashku me mentorin e saj nuk mund të ndërtojë stacion ku të dojë ajo larg syrit të kolegëve të tjerë dhe drejtuesit e tyre, në vende dhe godina që nuk janë pjesë e QSUNT, të cilat për momentin që po kalojmë janë bosh dhe nuk kanë asnjë lloj aktiviteti. Sipas M.I, ky është një precedent i rrezikshëm.

Sipas M.I, ankuesja kërkon të kryejë detyra funksionale për të cilat nuk ka tagër dhe që nuk i takojnë të kryejë, si atë të korrierit midis mentorit të saj dhe shefit të shërbimit. A.N është me

¹¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.613 prot., datë 12.4.2021.

¹² Protokolluar pranë Komisionerit me nr.617 prot., datë 12.4.2021.

statusin e specialistit dhe ka të tjera detyra. Ajo ankohet për mungesë kohe, por gjen kohë të bëjë me zell një gjë që nuk i takon.

Në lidhje me pretendimet e ankueses për etiketimin nga ana e M.I në mbledhjen e datës 27.9.2019 me termin “*rrugaçe*”, kjo e fundit shprehet se protokoli i mbledhjes nuk reflekton komunikim midis saj dhe ankueses, apo të mjekëve me njëri tjetrin. Pra, sipas M.I, pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Në lidhje me pretendimet e ankueses, për etiketimin me shprehjen “*një copë specializante*” përkundrejt ankueses, M.I shprehet se në 20 vite mësimdhënie ka respekt dhe dashuri për studentët në përgjithësi dhe për specialistët në veçanti. Sipas M.I, rasti i ankueses përbën një rast unikal referuar mënyrës së sjelljes së saj, me mungesë respekti, e më keq se kaq me mësuesin dhe pedagogun. M.I shprehet se me sjelljen e saj ndaj studentëve dhe specialistëve ka marrë ndër vite mirënjohjen dhe lavdet e tyre, të cilësuar këto edhe me shkrim.

Në lidhje me pretendimin e ankueses, se specialistët detyrohen të bëjnë punët e sekretarisë në shërbim, gjë që i pengon dhe ua redukton në mbi 70 % kohën që ata duhet të shpenzojnë për mësimin dhe formimin e tyre profesional, znj.IkonM.Iomi sqaron se, Shërbimi i Anatomisë Patologjike në organikën e tij nuk përmban sekretare dhe çdo punë kryhet nga mjekët dhe laborantët. Në të tilla kushte edhe specialistët përkrah mjekëve dhe në ndihmë të tyre kryejnë të njëjtin proces pune.

Puna e mjekut në shërbimin e anatomisë patologjike, kalon në tre procese, që janë: procesi i kampionimit dhe analizës makroskopike, procesi i ekzaminimit mikroskopik dhe vendosja e diagnozës si dhe procesi i hartimit dhe shkruarjes së diagnozës të konstatuar nga mjeku. Çdo specialist përkrah mjekut përkatës ka detyrimin sipas rregullores së specialistit të zhvillojë këto procese në kuadrin mësimor praktik.

Në rregulloren e studimeve të specialistëve, neni 3, parashikohet se specialisti angazhohet me kohë të plotë 40 orë në javë pranë strukturës ku është ngarkuar të ndjekë programin specializues dhe ka detyrimin të kryejë të paktën 24 roje klinike në vit. M.I shpjegon se, ankuesja angazhohet vetëm 30 orë në javë pranë shërbimit tonë (75% të angazhimit total të detyruar) kjo për arsye të punës 6 orëshe që ka shërbimi, si efekt i vështirësisë së punës si dhe nuk kryen roje klinike. Pra vetëm nga kjo mundësi ankuesja përfiton 10 orë në javë (25%) që ti përdori për studime teorike.

M.I shprehet se, sipas nenit 9, të rregullores, parashikohet se programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës dhe 20% për studime të organizuara teorike. Pra, sipas M.I, ankuesja duhet të kryejë pranë shërbimit 80% të 40 orëve në javë që përbëjnë 32 orë në javë aktivitet klinik, kur ndërkohë ankuesja bën vetëm 30 orë në javë. M.I, shpjegon se ankuesja duhet të konsiderojë dhe

të thellohet edhe në aspekte të tjera të kësaj rregullore si dhe kodit të etikës dhe deontologjisë, siç janë neni 60 i rregullores dhe neni 43 i kodit të etikës.

16. Me *e-mailin* e datës 5.5.2021, ankuesja ka depozituar prapësimet e saj në lidhje me shkresën e dërguar nga M.I, ku ndër të tjera parashtron:

Në lidhje me shkresën nr.1129/59 datë 2.3.2020 të QSUNT, sipas të cilës, pas një kontrolli të ushtruar nuk kanë respektuar orarin e punës dy ankuesit si dhe S.Z, I.L, e për rrjedhojë këtyre personave nuk do t'ju paguhej data 25.2.2020, ankuesja shprehet se nuk është njoftuar për një kontroll të tillë, por ka marrë dijeni vetëm pasi u njoh me kopjen e dokumentacionit nga Komisioneri.

Sipas ankueses një gjë e tillë ka ndodhur në mënyrë të përsëritur. Ankuesja shpjegon se në muajin shkurt, i janë hequr 4 ditë pune nga M.I por jo data 25.2.2020, siç është kërkuar nga drejtoria, por ditë të tjera sipas dëshirës së shefes. Pavarësisht urdhrin të drejtorisë së QSUNT, I.L, nuk i hiqet asnjë ditë pune në muajin shkurt. Ankuesja shprehet se asaj në mënyrë të vazhdueshme i hiqen ditët e punës dhe asnjë masë nuk është marrë.

Ankuesja shprehet se, pretendimet se ajo nuk paraqitet në shërbim nuk janë të vërteta. Ajo është paraqitur çdo mëngjes pranë shërbimit onkologjik për të kryer detyrat që i ishin caktuar dhe më pas për të marrë biopsitë të cilat do të zgjidheshin nga mentori i saj, me të cilat do të punonte edhe ajo për të mësuar. Sipas ankueses, heqja e ditëve të punës në mënyrë selektive kur ajo ka bërë çdo ditë të njëjtën gjë është e pakuptueshme.

Ankuesja shprehet se ka paraqitur vetëm një pjesë të vogël të dhunës së vazhdueshme psikologjike dhe verbale që sipas saj vazhdon më shumë se dy vite dhe nuk është ndërprerë. Ankuesja shprehet se shkresa e M.I është tendencioze dhe diskriminuese duke hamendësuar dhe nënkuptuar gjëra. Ankuesja shprehet se, i vjen shumë keq që në parashtrimet e saj, M.I, përpiqet ta paraqesë ankuesen si person problematik dhe studente të dobët, duke ulur ankuesen nga njëra anë dhe duke lartësuar veten kur ka qenë specializante. Ankuesja shprehet se ajo ka marrëdhënie shumë të mira dhe korrekte me të gjithë stafin përveç shefes dhe se ka mbyllur me rezultate të shkëlqyera 3 vitet e specializimit, me mesatare 10.0.

Lidhur me korrektesën në punë dhe faktin se specializantët e tjerë kanë konsiderata maksimale dhe shprehin në pusulla dhe kartolina, ankuesja shprehet se pjesa më e madhe në këtë shërbim kanë bërë përpjekje për tu transferuar, ndërkohë specializantët e tjerë janë të detyruar të bëjnë kompromise. Në lidhje me faktin e administrimit të kohës, ankuesja shprehet se ajo ka statusin e studentit dhe gjatë orëve të mësimit, nuk ka pse të bëjë sekretaren dhe pas mësimit të mësojë. Sipas ankueses ajo nuk ka ngritur pretendime në lidhje me shkrimin e fletëve të mjekëve por vetëm me procesin e recepsionit. Sipas saj, praktika e recepsionit nga ana e specializantëve është praktikë e vendosur nga shëfja, sepse më parë këtë proces pune e bënin laborantët.

Ankuesja shprehet se nëse para 1 viti është e dokumentuar që specialistët bënin reception, tashmë sipas saj shefja nuk e vendos më fjalën reception, sepse kuptohet që është shkelje, por e lë të nënkuptuar që mos të kenë si të ankohen. Ankuesja deklaron se, pavarësisht se mund të ketë patur mendime të ndryshme me shafen, në asnjë moment nuk i është shmangur detyrimeve të saj dhe ka zbatuar çdo urdhër, por nuk mund të tolerojë fyerjet dhe diskriminimin.

17. Me *e-mailin* e datës 5/5/2021, ankuesi L.B ka dërguar prapësimet përfundimtare në lidhje me ankesë, duke parashtruar ndër të tjera se:

Drejtoria e QSUNT nuk ka marrë asnjë masë parandaluese lidhur me përshkallëzimin e diskriminimit. QSUNT ka për detyrë verifikimin e shkeljeve të referuara nga kolektivi prej 5 personash për M.I, por nuk e ka bërë duke përdorur justifikimin se është prokuroria që po e ndjek çështjen. QSUNT duhet të kishte nisur një hetim të brendshëm nga sektori i auditit për të hetuar në lidhje me ankimin administrativ.

Ankuesi deklaron se, sipas kontratës me MARS dhe MSHMS, shefit të shërbimit i bëhet performancë 1 vjeçare për çdo vit dhe ngre pretendimin nëse një gjë e tillë është bërë për M.I. Sipas ankuesit, gjërat janë lënë në harresë dhe janë eliminuar një e nga një anëtarët e grupit kallëzues nga puna, me qëllimin që M.I dhe Drejtoria e QSUNT të mos shqetësohen.

Ankuesi shprehet se nuk i është komunikuar ndonjëherë shkresa nr.3400/1 datë 16.7.2018, sikundër edhe shumë dokumenta të tjerë që autorët e diskriminimit kanë akumuluar deri në ndërprerjen e kontratës.

Sipas ankuesit gjatë vitit 2020 prezenca e ankuesve verifikohet lehtësisht nga volumet e punës që ata kanë kryer. Prej datës 5 tetor ai shprehet se është njoftuar me *e-mail* drejtori i QSUNT për mungesat dhe ndërprerjen e punës, duke i kërkuar hetimin dhe zgjidhjen e kësaj problematike. Në vend të zgjidhjes së problemit, ankuesi shprehet se ka marrë një dokument të çuditshëm nr.2828/4 datë 27.10.2020, i cili u impononte rregulla të pashkruara të Shefes së Shërbimit. Ky dokument është nënshkruar nga znj. S.Z, ndërkohë që Laboratori i Anatomisë Patologjike është nën kompetencën e Dr.Sc A.S, e cila është anashkaluar në mënyrë të qëllimshme.

Ankuesi shpjegon se prej tërmetit të vitit 2019, për të kryer detyrat ndaj QSUNT si dhe funksionet akademike të pedagogut, ai ka transferuar vendodhjen në Katedrën e Anatomisë Patologjike që është brenda perimetrit të QSUNT, jo më larg se 80-100 m në vijë ajrore nga çdo spital. Pjesa tjetër e stafit u transferua në Spitalin Onkologjik, ku për shkak të ambienteve të vogla, mbas disa objeksioneve nga ana e stafit, vendosi që stafi të organizohej në dy pjesë që të altermoheshin me turne javore, gjysma punonte një javë dhe gjysma rrinte pushim. Një gjë e tillë u zbatua edhe nga ankuesi, por me ndryshimin sipas tij se, pedagogu duhet të ishte përditë në punë. Në këto kushte ankuesi shprehet se funksionet e veta pedagogjike dhe spitalore i realizonte nga zyra e katedrës. Ankuesi shprehet se është mungesë përgjegjësie, që në kohë pandemie të covid 19, ku janë në fuqi akte normative për shmangien e grumbullimeve, as në mbledhje dhe as

në ambjekte të tjera, të kërkosh që në ambient disa metra katror të rrinë 10 ose më shumë persona.

Në lidhje me performancën në punë, ankuesi shprehet se ajo është bërë në fshehtësi të plotë dhe nuk i është dhënë për firmë. Dokumenti ka ardhur pas një kërkese që është bërë për të kërkuar argumentimin në bazë të akteve të performancës.

Ankuesi shprehet se, kontrata me QSUNT prej 20 vitesh ka qenë një formalitet për të gjithë pedagogët, pasi ajo herë është nënshkruar çdo vit dhe here çdo 3-4 vjet. Ankuesi deklaron se nuk është pyetur ndonjëherë ndër vite nëse do ta rinovonte apo jo kontratën.

Ankuesi shprehet se nuk ka dijeni me gojë ose me dokument për asnjë lloj thyerje etike në punë, mosrespektim të hierarkisë. Ai ka zgjedhur të komunikoj me *e-maile*, pasi komunikimi verbal sipas tij kthehet nga M.I në konflikt verbal dhe më pas punonjësi kanoset në drejtori për thyerje të etikës. Sipas tij, mbledhja e mëngjesit nuk bëhet asnjë ditë nga M.I.

Rregullorja e Brendshme sipas ankuesit duhet të jetë krijuar pas padive kolektive dhe se asnjë nga mjekët dhe personeli nuk e ka patur në dispozicion. Rregullorja nuk është e afishuar në ambientet e punës në kundërshtim me Kodin e Punës.

Ankuesi deklaron se nuk ka dijeni për shkresat nr.2828/2, 25/2 dhe 2828/3 ndërsa në lidhje me shkresën nr.2828/4 ankuesi shprehet se e konsideron formë presioni për t'ju nënshtruar M.I. Sipas ankuesit, drejtorja e QSUNT ka vepruar në mënyrë të njëanshme duke ushtruar presion ndaj dëshmitarëve me qëllim nënshtrimin dhe persekutimin e tyre duke filluar që para 1 viti me znj. Sh.M.

Ankuesi shprehet se, Drejtorja e QSUNT ka krijuar një precedent të rrezikshëm me prishjen e kontratës, pasi kështu çenohet akademizmi i QSUNT, e cila është universitare pikërisht nga prezenca e pedagogëve. Standarti i një shërbimi nuk mund të mbahet me një pedagog të brendshëm. Sipas ankuesit, në faqen 5, pika b, theksohet subspecializimi i mjekëve, ndërkohë që mohohet nga shefja e shërbimit dhe bëhet presion ndaj tij, për braktisje kronike pacientësh. Ky fakt sipas ankuesit vë në pah standartet e shumëfishta që përdor Shefja e Shërbimit, sipas leverdisë në situata të ndryshme. Në lidhje me strukturën e shërbimit të anatomisë patologjike të paraqitur në faqen 8, pika 4 të rregullores së brendshme, sipas ankuesit mungojnë dy mjekë pedagogë (ai vetë dhe Dr.Sc.T.B ndërkohë që kjo rregullore është bërë në 2017)

Ankuesi shprehet se personalisht me disa shkresa dhe emaile i është referuar drejtorisë në lidhje me aktivitetin e tij ditor si pedagog, kërkues shkencor, detyrën si mbrojtës i studentëve apo edhe anëtar i Komisionit Institucional Zgjedhor ngarkuar nga dekani i Fakultetit apo edhe Rektori. Ankuesi thekson se asnjëherë nuk i është kërkuar atij ose ankueses Dr.Albinës që të japim shpjegime ose të paraqitemi në zyrën e shefes së shërbimit. Sipas tij heqja e 13 ditëve të punës në korrik 2020, ndërkohë që biopsitë janë kryer, janë rezultat i padisë së bërë kundër Shefes së

shërbimit në komisionin zgjedhor të fakultetit si person diskriminues dhe me dosje penale për vjedhje dhe falsifikim dokumentacioni në prokurori e cila edhe sot është aktive.

Sipas ankuesit për biopsitë e palcës, biopsitë jo tumorale të veshkave, shërbimi i anatomisë patologjike nuk ka metodikat e nevojshme për të realizuar në minimum këto ekzaminime dhe se objeksionet e tij i ka shprehur me shkrim dhe me gojë vazhdimisht. Ai nuk mund të pranojë që ta detyrojë të firmosë dhe legjitimojë “*malpraktikën e vet*”. Ai pranon se i realizon këto ekzaminime në institucion tjetër privat, ku realizohen metodikat e munguara në QSUNT.

Në lidhje me informacionin e shefes së shërbimit për numrin e biopsiove të kryera në 2019 dhe 2020, ankuesi sqaron se numri i tyre ka një kushtëzim “tavan”, pasi secili mjek realizon ato që i caktohen nga shefi i shërbimit dhe nuk mund të realizojë as më shumë e as më pak. Ajo që është e rëndësishme është të verifikoheshin këto ekzaminime për kohën e realizimit të tyre, për subspecialitetin e imponuar nga shefja e shërbimit, ndërkohë që pretendon se nuk i ka shpërndarë sipas subspecialitetit.

Ankuesi thekson gjithashtu se, parashtrimet e M.I, ndaj dy ankuesve në lidhje me shprehjet e përdorura nga kjo e fundit “.....ndërtimin e një stacioni pune larg syve të kolegëve në një godinë jofunksionale që përbën një precedent të rrezikshëm...; shkon në sinkron të gjithë ankesave dhe pohimeve të parashtruara për mungesë etike, mungesë profesionalizmi dhe edukate qytetare minimale nga ana e M.I.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Faktet dhe rrethanat në lidhje me ankuesin L.B.

Mbështetur në informacionin dhe provat e administruara, rezulton se ankuesi L.B punon në QSUNT në pozicionin mjek pedagog, në Shërbimin e Laboratorit të Anatomisë Patologjike, në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent, që prej vitit 2005.

Me shkresën nr.2828/5 prot datë 24.12.2020, ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e kontratës së shërbimit nr.3040/12 prot., datë 13.6.2018 të nënshkruar midis tij dhe QSUNT. Në këtë njoftim drejtuar ankuesit, QSUNT, parashtron se : “... Me shkresën nr.2828/3 prot., datë 26.10.2020 “Kërkesë për informacion” të Shefit të Shërbimit në detyrë Prof. M.I, jemi informuar mbi problematikat tuaja në punë lidhur me:

- *Komunikimin dhe bashkëpunimin me eprorin*
- *Mosparaqitje në vendin e punës në mënyrë të përsëritur*

- *Mosprezencën në mbledhjen e mëngjesit*
- *Refuzimin e detyrave të ngarkuara nga drejtuesi i shërbimit*
- *Braktisje e pacientëve në mënyrë të përsëritur*

Me formularin e vlerësimit të performancës së mjekut nr.2574/52 prot., datë 13/8/2019, të Shefit të Shërbimit Prof. M.I, jemi informuar mbi vlerësimin jo pozitiv të performancës tuaj në shërbim lidhur me:

- *Komunikimin dhe bashkëpunimin*
- *Planifikimin dhe organizimin e punës*
- *Zgjidhjen e problemeve*
- *Përdorimin e teknologjisë.*

Me shkresën Nr.3400/40 prot., datë 16.12.2020 “Informacion”, të Shefit të Shërbimit të Anatomisë Patologjike Prof M.I, jemi informuar mbi moskryerjen e detyrave tuaja funksionale të pasqyruara në aneks kontratën e sipërcituar si dhe mosrespektimin e rregullores së spitalit, duke sjellë pengesë në shërbim. Me anë të listëprezencave të shërbimit të anatomisë patologjike, jemi informuar mbi mungesat tuaja në punë për muajin korrik, tetor dhe nëntor.

Sa më sipër, referuar kontratës së shërbimit nr.3040/12 prot., datë 13/6/2018, neni 6 kohëzgjatja e kontratës, në respektim të afatit 5 ditor të njoftimit, ju bëjmë me dije zgjidhjen e saj në datë 31.12.2020”

QSUNT, nuk mori në konsideratë kërkesën e Komisionerit për të garantuar të drejtën e ankuesit për të vazhduar punën deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës dhe për rrjedhojë ankuesi është larguar nga QSUNT,që prej datës 31.12.2020.

Faktet dhe rrethanat në lidhje me ankuesen A.N.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, rezulton se ankuesja A.N, është në QSUNT me statusin e mjekut specializant për ndjekjen e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, në programin e studimit të ciklit të tretë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë në degën Anatomii Patologjike, për periudhën 15.5.2018 deri më datë 14.5.2022, bazuar në kontratën nr.2933/17 prot., datë 3.5.2018, të lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Midis Ankueses dhe QSUNT nuk rezulton të jetë nënshkruar ndonjë akt i shkruar për rregullimin e marrëdhënieve midis tyre, përveç një deklarate me shkrim (pa datë) të lëshuar nga ankuesja. Referuar kësaj deklarate, ankuesja deklaroi se ka lidhur kontratë me MSHMS për ndjekjen e specializimit për periudhën 15/5/2018 deri 14.5.2022.

Aktualisht ankuesja A.N vazhdon të jetë mjekë specializante pranë shërbimit të anatomisë patologjike në QSUNT.

Në lidhje me statusin e ankuesve në raport me QSUNT

Ankuesi pretendon se është diskriminuar në të drejtën e tij për punësim ndërkohë që QSUNT prapëson se kontrata e lidhur midis saj dhe ankuesit L.B nuk është një kontratë pune por një kontratë shërbimi. Në këto kushte, në radhë të parë Komisioneri, do të ndalet për të sqaruar natyrën e marrëdhënies juridike midis ankuesit dhe QSUNT.

Bazuar në aktet e administruara dhe konkretisht kontratës së lidhur midis palëve në 2018, përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë se, përveç legjislacionit të posaçëm në fushën e arsimit të lartë, aktet normuese të Universitetit të Mjekësisë, apo akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e QSUNT-së, Kodi i Punës përbën bazën ligjore që rregullon marrëdhëniet midis palëve. Aneks Kontrata nr. 3040/13 prot., datë 13.06.2018, thekson se ankuesi L.B, në cilësinë e ofruesit të shërbimit, duhet të njohë dhe respektojë dispozitat e Kodit të Punës. Kontrata e lidhur mes palëve, nuk përmban dispozita të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e shërbimit.

Për të vendosur në lidhje me natyrën juridike të marrëdhënies të krijuar midis palëve në këtë ankesë, referenca do të jetë tek parashikimet e Kodit të Punës, i cili rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e punësimit dhe të drejtën për punë.

Bazuar në nenin 12, të Kodit të Punës, të ndryshuar, parashikohet : *“Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.”*

Sikundër përcaktohet në nenin 12, të K.Punës, kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, natyra e vërtetë e marrëdhënieve mes palëve, përcaktohet bazuar në dispozitat e Kodit të Punës. Sa më sipër, për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie punësimi, duhet të vlerësohen aspektet e mëposhtme:

- Punëmarrësi e ofron punën ose shërbimin në kuadër të organizimit dhe urdhrave të punëdhënësit. Kjo do të thotë se punëdhënësi është ai që ka kontrollin e punës. Kjo nënkupton që punëmarrësi është në varësinë e punëdhënësit, për sa i përket orarit dhe disiplinës në punë.

- Puna ose shërbimi kryhet për përfitim të punëdhënësit dhe se puna apo shërbimi detyrimisht duhet të kryhet personalisht nga punëmarrësi. Detyrimi i kryerjes së punës personalisht nga punëmarrësi parashikohet në mënyrë specifike nga neni 22, i Kodit të Punës¹³.
- Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se puna ose shërbimi ofrohen kundrejt një shpërblimi. Shpërblimi për punën ose shërbimin është një pagesë periodike. Periodiciteti i pagës parashikohet nga neni 116, i Kodit të Punës ku përcaktohet se, *punëdhënësi i paguan rregullisht pagën punëmarrësit çdo dy javë, kur paga llogaritet me orë, ditë ose javë dhe në fund të çdo muaji kur llogaritet me muaj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshje me shkrim*. Shpërblimi për punën ose shërbimin, është një pagesë që nuk kërkohet përmes faturave ose në përfundim të një kontrate për ofrimin e shërbime të përcaktuara.
- Vendosja e një marrëdhënie punësimi midis palëve sjell njohjen e të drejtave të tilla si pushimi javor apo pushimi vjetor, pushimi në ditët e festave zyrtare, sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

Nga zbatimi i aspekteve të mësipërme në çështjen objekt shqyrtimi, Komisioneri vlerëson se, marrëdhënia juridike midis ankuesit L.B dhe QSUNT është një marrëdhënie juridike punësimi, pavarësisht se emërtimi formal i kontratës së nënshkruar nga palët është kontratë shërbimi. Ky përfundim i arritur nga Komisioneri, bazohet në arsyetimin e mëposhtëm:

Puna ose shërbimi i ofruar nga ankuesi për QSUNT ofrohet në kuadër të organizimit dhe urdhrave të QSUNT-së. Pra, është QSUNT që ka kontrollin e punës. Kjo nënkupton që ankuesi është në varësinë e QSUNT, për sa i përket orarit dhe disiplinës në punë. Disiplinimi dhe orari i punës përcaktohet edhe në nenin 3, të kontratës që palët kanë nënshkruar. Puna ose shërbimi i ofruar nga ankuesi bëhet për përfitim të QSUNT dhe ankuesi e ofron shërbimin ose kryen punën që i ngarkohet, personalisht.

Një nga aspektet me rëndësi në përcaktimin e faktit nëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune, është shpërblimi për punën ose shërbimin. Në rastin objekt shqyrtimi, shpërblimi i ankuesit bëhet në mënyrë periodike, kundrejt listëprezencave të mbajtura nga QSUNT dhe ky shpërblim nuk është i kërkueshëm nga ankuesi përmes faturave ose në përfundim të kontratës për punën e kryer ose shërbimin e ofruar.

Referuar kontratës së nënshkruar nga palët, ankuesit i njihen të drejta të tilla si pushimi javor, dhe vjetor i paguar si dhe pushimi në ditët e festave zyrtare.

¹³ Neni 22, i Kodit të Punës: “1. Punëmarrësi kryen personalisht punën e ngarkuar, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje parashikohet e kundërta. 2. Nuk është i vlefshëm zotimi i punëmarrësit për t’i siguruar punëdhënësit një zëvendësues, kur ai nuk është i detyruar të punojë si pasojë e zbatimit të këtij Kodi.”

Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se natyra juridike e marrëdhënies së krijuar midis ankuesit L.B dhe QSUNT është një marrëdhënie juridike punësimi, dhe për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit se është diskriminuar do të trajtohet në kuadër të pretendimeve për diskriminim në fushën e punësimit.

Ankuesja A.N, në QSUNT gjendet me statusin e mjekut specializant, për ndjekjen e studimeve të specializimit afatgjatë, në programin e studimit të ciklit të tretë në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, për të cilën ka lidhur edhe kontratë me MSHMS. Bazuar në Rregulloren e Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, e cila është miratuar me vendimin nr.88, datë 16.11.2016, të Senatit Akademik, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me ndryshimet përkatëse, ankuesja A.Ngëzon statusin e studentit. Kjo rregullore, përveç kuadrit ligjor të posaçëm në fushën e arsimit të lartë dhe aktet e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, bazohet edhe në dispozitat e Kodit të Punës, pasi sikundër parashikohet në nenin 13 të saj, mjeku angazhohet me kohë të plotë 40 orë në javë pranë strukturave ku është përcaktuar. Për punën dhe shërbimet e ofruara gjatë kohës që mjeku specializant kryen specializimin afatgjatë, atij i garantohet shpërblimi për punën/shërbimin e ofruar.

Bazuar në aktet e administruara dhe në zbatim të kriterëve të mësipërme, mbi bazën e të cilave vlerësohet natyra e marrëdhënies juridike të vendosura midis palëve, rezulton se edhe për rastin e ankueses A.N janë njësoj të zbatueshme kriteret dhe arsyetimi i tyre si në rastin e ankuesit L.B. Ankuesja A.N e kryen punën dhe shërbimin e saj pranë QSUNT, nën organizimin dhe urdhrat e kësaj të fundit, konform orarit dhe disiplinës të caktuar prej QSUNT; ankuesja e kryen punën/shërbimin personalisht dhe përfiton një shpërblim periodik; ankuesja gjithashtu si mjek specializant është përfituese e pushimit javor dhe vjetor të paguar dhe përfiton pushim për ditët e festave zyrtare.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se natyra juridike e marrëdhënies së krijuar midis ankueses A.N dhe QSUNT është një marrëdhënie juridike punësimi, dhe për rrjedhojë, pretendimet për diskriminim të ankueses do të trajtohet në kuadër të pretendimeve për diskriminim në fushën e punësimit.

Pavarësisht se ankuesja A.N dhe QSUNT nuk kanë lidhur ndonjë kontratë për të normuar marrëdhëniet midis tyre, një fakt i tillë nuk çënon faktin e ekzistencës së marrëdhënies juridike të punësimit, pasi referuar nenit 21, pika 2, të Kodit të Punës, kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se marrëdhëniet midis ankueses, MSHMS, Universtitetit të Mjekësisë Tiranë dhe QSUNT, janë të ndërlidhura, nga ana tjetër kanë natyra të ndryshme juridike. Për shkaqet e mësipërme marrëdhënia e vendosur midis ankueses dhe QSUNT, është një marrëdhënie pune, edhe pse e një natyre të veçantë për shkak të faktit se ankuesja si mjeke specializante, referuar rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, gëzon statusin e studentes.

Në lidhje me pretendimet e ankuesve për vendosjen e mungesave në listëprezenca.

Të dy ankuesit pretendojnë se, gjatë vitit 2020, ndaj tyre janë vendosur në mënyrë abuzive, mungesa në listëprezenca, nga ana e Shefes së Shërbimit. Kulminacionin një praktikë e tillë për heqjen e ditëve të punës, sipas ankuesve ka ndodhur në muajin korrik 2020, kur ndaj ankuesve janë hequr 12 ditë punë, duke qenë përditë në punë dhe duke realizuar biopsitë me firma dhe datat përkatëse. Sipas ankuesit L.B, që prej datës 21.9.2020, atij nuk i jepej më punë nga ana e Shefes së Shërbimit, por listëprezenca për këtë muaj është plotësuar e plotë. Ankuesi L.B pretendon se edhe muaji tetor e nëntor, 2020, kanë vazhduar të plotësohen me mungesa në listëprezenca, në mënyrë abuzive.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, rezulton se, në muajin korrik 2020, ankuesi L.B, figuron në listëprezencën e këtij muaji, me 12 ditë mungesë, ndërsa ankuesja A.N, figuron me 9 ditë mungesë. Përveç heqjes së ditëve të punës dhe për rrjedhojë mospagesën e ditëve me mungesë, nuk rezulton që nga ana e Shefes së Shërbimit dhe QSUNT-së, të jetë filluar ndonjë procedurë disiplinore, edhe pse është pretenduar se ankuesit nuk janë paraqitur në punë pa arsye. Referuar listë prezencës mujore për muajin shtator 2020, rezulton se të dy ankuesit nuk figurojnë që të kenë patur mungesa në punë. Nëse muaji tetor dhe nëntor kanë vijuar pa mungesa për ankuesen A.N, situata rezulton ndryshe për ankuesin L.B. Bazuar në listë prezencat e muajve tetor dhe nëntor 2020, ai figuron me mungesë totale të prezencës së tij në punë.

Në datën 14.9.2020, rezulton që në QSUNT të jetë protokolluar me nr.2828 prot, datë 14.9.2020, një ankesë e bërë nga dy ankuesit, në lidhje me heqjen e ditëve të punës, në mënyrë abuzive dhe të pabazuar, nga ana e Shefes së Shërbimit kundrejt tyre. Me shkresën nr.2828/1 prot datë 17.9.2020, Drejtori i Burimeve Njerëzore në QSUNT, ka kërkuar nga M.I, konfirmimin nëse listë prezencat janë korrekte apo kanë nevojë për ndryshime. Shefja e Shërbimit, M.I, me shkresën e protokolluar me nr.2828/2 prot., datë 06. 10.2020, informon se, në kushtet e refuzimit të punës së ngarkuar si dhe mospjesmarrjes në mbledhje apo kontaktit fizik me drejtuesin e shërbimit, ajo nuk mund të plotësonte listëprezencat për këto ditë, kjo nisur edhe nga mungesa e një godine të vetme pas dëmtimit dhe shpalljes së papërdorshme të godinës së Shërbimit të Anatomisë Patologjike.

Në datë 5.10.2020, me anë të e-mailit, ankuesi i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT-së, duke i komunikuar ndër të tjera, shqetësimin për heqjen e ditëve të punës, faktin se që prej datës 21 shtator ankuesit nuk i shpërndaheshin biopsi për zgjidhje nga Shefja e Shërbimit. Referuar këtij e-maili, ankuesi gjithashtu shprehet se, që nga koha e tërmetit të 2019, vendodhja e tij e punës ka qenë në Katedrën e Anatomisë Patologjike dhe se në situatën e pandemisë së Covid, çdo marrëdhënie me shërbimin ai e ka kryer nëpërmjet Kryelaborantes dhe specializantit mentor i të cilit ai ishte. Bazuar në kopjet e e-maileve të vendosura në dispozicion nga ankuesi L.B, rezulton se, në datë 26.10.2020, ankuesi i është drejtuar përsëri Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me problematikat e mësipërme.

Më shkresën nr.2828/4 prot., datë 27.10.2020, drejtuar ankuesit L.B, Drejtori i Burimeve Njerëzore, në QSUNT, shprehet se: *“Bazuar në shkresën tuaj nr.2828 prot., datë 14/9.2020, lidhur me ankesën për mospagesën e ditëve të punës në korrik 2020, si dhe shkresës nr.2828/2 prot, datë 6.10.2020 “Informacion”, të Shefit të Shërbimit, me anë të së cilës referohet mosparaqitja juaj në vendin e punës dhe në mbledhjet e mëngjesit: Ju bëjmë me dije për detyrimin tuaj për paraqitjen në vendin e punës dhe respektimin e komunikimit të Shefit të Shërbimit, si titullari juaj i drejtpërdrejtë. Sa më sipër ju tërhiqet vëmendja për shkelje të detyrave funksionale të pasqyruara në Rregulloren e QSUT “Nënë Tereza”, të vendimit nr.7, datë 21.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së funksionimit të QSUT, të Bordit Drejtues të Spitaleve Universitare: “Shefi i Shërbimit drejton mbledhjen e mëngjesit, ku raporton mjeku i rojes mbi shtrimet e kryera në ditën pararendëse dhe gjithçka që ka ndodhur në shërbim, verifikon prezencën e personelit të lartë dhe përcakton detyrat e ditës”.*

Ankuesi L.B prapësoi se, refruar kontratës që ai ka me QSUNT, nuk rezulton e përcaktuar në mënyrë eksplicite se cili është vendi i punës në aspektin fizik. Sipas tij, rëndësi ka kryerja e biopsive dhe jo vendi ku ato kryehen, në kushtet kur kemi të bëjmë me një qendër spitalore universitare, ku Fakulteti i Mjekësisë është i integruar brenda vet qendrës.

Gjithashtu, ankuesi pretendon se është i pabazuar pretendimi se ai ka shkelur detyrimet kontraktuale që burojnë nga neni 3, i kontratës që ai ka nënshkruar me QSUNT. Ankuesi, pretendon se ka përmbushur detyrimin kontraktor të parashikuar nga neni 3, pasi ai ka kryer punën si pedagog dhe ka njoftuar mbi vendin e punës në katedër për realizimin e detyrave në lidhje me Shërbimin e Anatomisë Patologjike, sa kohë që ndërtesa e këtij shërbimi ka qenë jofunksionale si pasojë e tërmetit.

Në nenin 3, të kontratës të lidhur midis ankuesit L.B dhe QSUNT-së, parashikohet:

- 1. Në kohën normale të punës do të hyjnë dhe orët gjatë të cilave mjeku/pedagogu kryen aktivitetin pedagogjik në funksion të Fakultetit të Mjekësisë, por duke paraqitur nga ky universitet çdo semestër ngarkesën/orarin mësimor.*

2. *Padagogu ka detyrimin të paraqesë në Drejtori, nëpërmjet shefit të shërbimit, planin mësimor, çdo muaj nga data 1 deri në datën 4. Në përputhje me ngarkesën mësimore individuale të vërtetuar nga Fakulteti i Mjekësisë, përfituesi përcakton kohën e punës së mjekut/pedagogut në shërbim.*
3. *Koha normale e punës do të jetë 40 orë/javë. Për nevoja të domosdoshme të procesit të punës, me dijeninë e punëdhënësit, punëmarrësi mund të punojë edhe jashtë orarit ditor, por jo më shumë se 200 orë në vit.*

Bazuar në shkresën nr.21/1 prot., datë 06.1.2021, drejtuar Rektorit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë, informon se: “...Dr.Shk. L.B, pedagog me kohë të plotë pranë Departamentit të Anatomisë Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore, Fakulteti i Mjekësisë UMT, ka një vlerësim pune dhe performancë të shkëlqyer si mësimdhënës në lëndën Anatomia Patologjike dhe asnjë mungesë në punë për periudhën 1.6.2020 -31.12.2020”. Referuar listëprezencave të pedagogëve të Departamentit të Anatomisë Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore, që i bashkëlidhen kësaj shkrese, rezulton se ankuesi për periudhën e sipërcituar, nuk ka asnjë mungesë në punë.

Bazuar në aktet e administruara, nuk rezulton që QSUNT dhe M.I, Shefe e Shërbimit, të kenë verifikuar në lidhje me aktivitetin pedagogjik të ankuesit, në funksion të Fakultetit të Mjekësisë. Aktiviteti pedagogjik i ankuesit në Fakultetin e Mjekësisë, është pjesë e kohës së punës, sipas kontratës dhe bazuar në listëprezencat e Fakultetit të Mjekësisë, rezulton i provuar aktiviteti pedagogjik i ankuesit pa asnjë ditë mungesë në punë. Për rrjedhojë, QSUNT dhe M.I, Shefe e Shërbimit, nuk kanë respektuar këtë parashikim kontraktor në përpilimin e listë pagesave dhe përlogaritjen e kohës së punës për rastin e ankuesit L.B.

QSUNT dhe M.I, Shefe e Shërbimit, pranojnë dhe nuk e kundërshtojnë faktin se ankuesi që prej tërmetit të muajit nëntor 2019 e ka ushtruar aktivitetin e tij për kryerjen e detyrave të tij funksionale, sikundër është kryerja e biopsive, në Katedrën e Anatomisë Patologjike dhe jo në godinën ku ishte zhvendosur Shërbimi i Anatomisë Patologjike. Një situatë e tillë nuk është ngritur si problem nga Shefja e Shërbimit dhe nuk është konsideruar si mosparaqitje në punë. Ankuesi ka vazhduar normalisht punën edhe pse, nuk i ka realizuar fizikisht detyrat e tij funksionale në godinën ku është sistemuar shërbimi, pas dëmtimit të godinës nga tërmeti i vitit 2019. Nga aktet e administruara rezulton se në muajin qershor 2020 ankuesit i është shpërndarë për trajtim biopsia nr.1992/2020. Gjithashtu nga informacioni i vendosur në dispozicion nga Shefja e Shërbimit M.I, rezulton se gjatë vitit 2020, ankuesit i është shpërndarë punë edhe pse ai nuk ka qenë fizikisht në të njëjtën godinë, që pretendohet si kusht për të konsideruar prezencën e tij në punë.

Të dy ankuesit kundërshtojnë pretendimin e M.I në lidhje me mbledhjet e mëngjesit, të cilat sipas tyre nuk realizohen, sikundër pretendohet prej saj. Bazuar në kopjet e regjistrit të mbledhjeve të mëngjesit, të vendosura në dispozicion nga QSUNT dhe M.I, mbledhje e cila

shërben edhe si mjete kryesor për të verifikuar prezencën në punë të personelit, rezulton se procesverbali i mbledhjes mbahet dhe nënshkruhet nga vetë Shefi i Shërbimit. Një dokument i tillë nuk provon prezencën ose jo të personelit, në kushtet kur ka kundërshtime në lidhje me prezencën në punë. Nga ana tjetër, ankuesi edhe pse ka vazhduar të kryejë detyrat nga Katedra e Anatomisë Patologjike, e cila është pjesë e Universitetit të Mjekësisë, por kundërshtohet nga QSUNT dhe M.I, se nuk është pjesë e QSUNT, është konsideruar se ka qenë prezent në punë, referuar listë prezencës për muajin shtator 2020. Ndërsa për muajt në vijim, tetor, nëntor, dhjetor, 2020, ai konsiderohet se nuk është paraqitur në punë, pasi Shefja e Shërbimit nuk ka realizuar kontaktin fizik, në mbledhjen e mëngjesit. Edhe gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, ankuesi rezulton të ketë kryer aktivitetin e tij pedagogjik, sikundër rezulton nga listëprezencat e Fakultetit të Mjekësisë. Edhe për këta muaj rezulton se QSUNT dhe M.I nuk kanë respektuar nenin 3 të kontratës së lidhur me ankuesin, në lidhje me llogaritjen e kohës së tij të punës. Ndryshe nga ankuesi L.B, rezulton se, ankuesja A.N, është pasqyruar pa asnjë mungesë në listëprezencat e muajve të mësipërm.

Në lidhje me prezencën në punë të ankueses A.N, M.I mban qëndrime kontradiktore, ndërsa shprehet më shkresën nr.60 prot datë 11.1.2021 se mjekja specializante vijon rregullisht të paraqitet në punë, me shkresën nr. 617 prot datë 12.4.2021, M.I shprehet ankuesja ka braktisur vendin e punës.

Ankuesit kundërshtuan dijeninë në lidhje me pretendimet e QSUNT dhe M.I, në lidhje me mosprezencën e tyre në shërbim gjatë një kontrolli të realizuar në datën 25.2.2020. Referuar shkresës nr.1124/59 prot., datë 2.3.2020, e cila kundërshtohet nga të dy ankuesit se kanë patur dijeni, të dy ankuesit, së bashku me dy punonjës të tjerë të Shërbimit të Anatomisë patologjike, janë gjetur në shkelje të orarit zyrtar të punës. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka kërkuar nga Drejtoria Ekonomike dhe e Planifikimit Financiar në QSUNT duke vendosur në dijeni edhe Shefin e Shërbimit, se data 25.2.2020 për këta punonjës nuk do të paguhet. Por një gjë e tillë nuk rezulton të ketë ndodhur për ankuesit, të cilët, sipas listëprezencës për muajin shkurt 2020, të hartuar dhe konfirmuar më pas nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk rezultojnë në mungesë për datën 25.2.2020, por u janë hequr ditë të tjera pune, të cilat ankuesit pretendojnë se i'u janë hequr në mënyrë abuzive dhe sipas preferencës së Shefes së Shërbimit. Ndërkohë punonjësja tjetër mjekje specializante që është konstatuar gjatë kontrollit të ushtruar se kishte qenë në mungesë, nuk rezulton t'i jetë hequr dita e punës për datën 25.2.2020.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit L.B për fyerje për shkak të bindjeve fetare.

Ankuesi shprehet se ai dhe bashkëshortja e tij janë besimtarë muslimanë dhe punojnë prej 20 vitesh në një katedër me M.I. Gjatë diskutimeve mes kolegësh ai shprehet se M.I gjithmonë ka patur kundërshtime. Ankuesi pretendon përdorimin nga ana e M.I, të fjalëve fyese, të tilla si “muslimanë të qelbur” apo “fondamentalistë islamikë”, kundrejt tij dhe bashkëshortes së tij

Dr.T.B, e cila ka punuar në QSUNT si mjeke pedagoge. Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës hetimore, ky pretendim i ankuesit nuk rezultoi i provuar.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit L.B, për përdorimin e një terminologjie diskriminuese për shkak të gjendjes martesore.

Ankuesi, pretendon se përdorimi nga ana e M.I, në bisedat e zakonshme por edhe në dokumenta zyrtarë në drejtori, të termave të tillë si, si “bashkëshortët B apo çifti B” ose “dy mjekët bashkëshortë” janë diskriminuese, për shkak të gjendjes martesore.

Nga informacioni dhe aktet e administruara, rezulton se, M.I i referohet ankuesit dhe bashkëshortes së tij me terminologjinë e sipërcituar, por në vlerësimin e Komisionerit nuk jemi në kushtet që kjo terminologji të mund të konsiderohet si një gjuhë shqetësuese apo që cënon dinjitetin e personit.

Në lidhje me pretendimet e ankueses A.N, për sjellje shqetësuese dhe përdorimin e fjalëve fyese, nga ana e M.I dhe mosmarrjen e masave nga ana e QSUNT-së, për trajtimin e ankesës.

Ankuesja pretendoi, se në mënyrë të vazhdueshme ndihet e shqetësuar nga sjellja dhe komunikimi i M.I, si Shefe e Shërbimit. Në mënyrë të veçantë ankuesja, pretendon se në mbledhjen e datës 27.9.2019, në prezencë të të gjithë kolektivit, M.I ka përdorur ndaj saj fjalë fyese si “rrugace”. Në lidhje me këtë ngjarje, ankuesja parashtron se ka paraqitur ankesë, kundër Shefes së Shërbimit, pranë QSUNT, por përveç një takimi qetësues, sipas ankueses sa për të kaluar radhën me Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, asnjë masë tjetër nuk është ndërmarrë, ndërkohë që sipas saj situata diskriminuese ka vazhduar të thellohet.

Në lidhje me këto pretendime të ankueses, QSUNT dhe M.I, nuk paraqitën asnjë shpjegim dhe nuk mbajtën asnjë qëndrim në parashtrimet e tyre fillestare. Në mënyrë specifike, Komisioneri kërkoi nga këto subjekte që të parashtronin jo vetëm qëndrimin e tyre në lidhje me këto pretendime të ankueses, por edhe të vinin në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me këto çështje.

M.I, në përgjigjen e dërguar me shkresën nr.617, datë 12.4.2021, e mohon faktin që, në mbledhjen e datës 27.9.2019, të ketë patur komunikim apo debat midis saj dhe ankueses, por as komunikim midis mjekëve me njëri tjetrin, fakt ky që rezulton nga protokollin e mbledhjes. Bazuar në procesverbalin e mbledhjes së datës 27.9.2019, të administruar, rezulton se protokollin është mbajtur nga vet M.I dhe është nënshkruar vetëm prej saj dhe jo nga punonjës të tjerë që mund të kenë marrë pjesë në këtë mbledhje. Komisioneri vlerëson se një akt i tillë nuk mund të konsiderohet si mjet provues për sa kohë që pretendimet kundërdrejtohen ndaj M.I, e cila si mbajtëse e brocesverbalit, është në kushtet e konfliktit të interesit.

Ndërsa QSUNT, me shkresën nr. 801/5 prot., datë 9.4.2021, pranon faktin se ankuesja ka bërë ankesë ndaj Shefes së Shërbimit në lidhje me sjelljen e kësaj të fundit ndaj ankueses. Sikundër pretendon edhe ankuesja, veprimi i vetëm që QSUNT ka bërë ka qenë një takim në të cilin kanë dëgjuar ankuesen dhe shpjegimet e saj në lidhje me situatën. Pra, rezulton se QSUNT, nuk kanë marrë asnjë masë për trajtimin në mënyrë efektive të ankesës së paraqitur nga ankuesja, pasi nuk ka filluar asnjë procedurë për verifikimin e pretendimeve të ankueses.

Në lidhje me kushtet e punës për ankuesen A.N, si mjeke specializante.

Sipas ankueses, mjekët specializantë konsiderohen nga ana e Shefes së Shërbimit se nuk kanë të drejtë të japin mendime dhe se, të kesh mendim ndryshe quhet “të ka marrë koka erë”. Sipas ankueses, nën drejtimin e M.I, si Shefe Shërbimi, specializantët, sikundër ajo vetë, ngarkohen me punë të tilla si, bërja e shërbimit të recepsionistit, punë me të cilën, jo vetëm ajo, por edhe specializantë të tjerë, nuk janë dakort, pasi i pengon nga qëllimi final për të cilin specializantët ndodhen në QSUNT. Ankuesja shprehet se angazhimi i specializantëve me punë sekretarie sikundër është shërbimi i recepsionit, ua redukon kohën që ata duhet të shpenzojnë për mësimin dhe formimin e tyre profesional.

ZnjM.I, prapëson pretendimet e ankueses duke sqaruar se Shërbimi i Anatomisë Patologjike nuk ka sekretare në organikën e tij dhe çdo punë kryhet nga mjekët dhe laborantët. Sipas M.I, në të tilla kushte edhe specializantët përkrahë mjekëve dhe në ndihmë të tyre kryejnë të njëjtin proces pune.

Referuar programit të javës 12-16 prill 2021 dhe 23-26 mars 2021, të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, të administruar në dosje, rezulton se, një prej ndarjeve të proceseve të punës ku nuk është shënuar emërtimi i procesit, ndryshe nga ndarjet e tjera, të cilat janë të përcaktuara si kampionimi apo ekzaminimi në mikroskop, janë shënuar vetëm emrat të specializantëve. Ky proces i pa emërtuar, pretendohet nga ankuesja se është pikërisht detyrimi për kryerjen e shërbimit të recepsionit, vetëm për mjekët specializantë. Ankuesja vendosi në dispozicion, kopje të programit të muajit korrik 2019, të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, nga ku rezulton se për periudhën 15-19 korrik 2019, punonjësit e ngarkuar me shërbim recepsioni janë vetëm mjekët specializantë.

Referuar nenit 48 të Rregullores së Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, ndër të tjera parashikohet se, objektivat kryesore të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore - shkencore dhe nxitja e punës në ekip e

studentëve. Studenti duhet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimit.

Bazuar në nenin 3, të Rregullores së Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, parashikohet se, specializantët duhet të angazhohen me 40 orë në javë pranë strukturave ku janë duke kryer specializimin dhe të kryejnë të paktën 24 roje klinike në vit. Për shkak të natyrës së punës në Shërbimin e Anatomisë Patologjike, personat që punojnë në këtë shërbim, punojnë 6 orë në ditë dhe jo 8 orë në ditë, si dhe nuk kryejnë roje klinike. Në këtë mënyrë, ankuesja A.N, angazhohet 30 orë në javë dhe jo 40 orë në javë, si dhe nuk kryen roje klinike, sikundër kërkohet nga rregullorja e specializimeve afatgjata. Konstatohet se, ankuesja A.N, përmbush detyrimet e saj në përputhje me mënyrën e punës së përcaktuar për Shërbimin e Anatomisë Patologjike ku është caktuar të kryejë studimet afatgjata, dhe shmangia nga parashikimi i mësipërm i rregullores, nuk varet nga vullneti apo sjellja e saj.

Në lidhje me procedurën e zgjidhjes së kontratës për ankuesin L.B.

Komisioneri ndryshe nga sa pretendoi QSUNT, se marrëdhënia midis saj dhe ankuesit L.B rregullohet nga një kontratë shërbimi dhe nuk përbën një marrëdhënie pune, sikundër është arsyetuar më sipër, vlerëson se jemi përpara një marrëdhënie juridike pune. Palët, pavarësisht përdorimit të termave ofrues shërbimi apo përfitues i shërbimit, në fakt janë në pozitë e punëmarrësit për ankuesin L.B dhe punëdhënësit për QSUNT. Për rrjedhojë zgjidhja e kontratës së lidhur midis palëve, duhet të bëhet konform procedurës dhe afateve të njoftimit të parashikuara nga Kodi i Punës, i cili përbën edhe bazën ligjore të vendosur në kontratën e lidhur midis palëve.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se, zgjidhja e kontratës i është komunikuar ankuesit me shkresën nr. 2828/5 prot., datë 24.12.2020 dhe njoftimi për zgjidhjen e saj referon tek nenit 9, i kontratës, ku parashikohet një afat njoftimi 5 ditor. Ankuesi nuk rezulton që të jetë thirrur për t'u dëgjuar në lidhje me arsyet e zgjidhjes së kontratës sikundër kërkon procedura e parashikuar nga Kodi i Punës në nenin 144 të tij.

Problematikat referuar nga QSUNT në njoftimin për zgjidhjen e kontratës me ankuesin, konsistojnë në problematika që janë referuar nga M.I, Shefe e Shërbimit, me shkresën nr.2828/3 prot., datë 26.10.2020. QSUNT, në njoftimin për zgjidhjen e kontratës shprehet se është kjo shkresë që ka bërë ata me dije në lidhje me problematikat, por nga aktet rezulton e kundërta pasi palët në lidhje me problematikat në fjalë kanë shkëmbyer një sërë shkresash dhe komunikime elektronike. Kjo shkresë i drejtohet Zv.Drejtoreshës së QSUNT, znj. A.S, në varësinë e të cilës është Shërbimi i Anatomisë Patologjike. Nga ana e znj. A.S nuk rezulton që të

jetë mbajtur asnjë qëndrim në lidhje me problematikat e parashtruara, që në fakt janë përgjigje dhe vijim i ankesës që dy ankuesit kishin depozituar për heqjen e ditëve të punës.

Në këtë shkresë, nga ana e Shefes së Shërbimit ngrihen pretendime në lidhje me mosparaqitjen në punë dhe mbledhjen e mëngjesit, të cilat nuk mund të mos kenë qënë të njohura për QSUNT pasi ka korrespondencë të mëparshme mes palëve, por edhe për shkak se listëprezencat e përgatitura nga Shefi i Shërbimit verifikohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bazuar në urdhrin e brendshëm nr.271, datë 27.8 2014 “*Për plotësimin dhe dorëzimin e listë-prezencave të personelit të QSUNT*”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioneri ka konstatuar se mbajtja e listëprezencave dhe heqja e ditëve të punës, ishte e pabazuar.

Për sa i përket problematikave në komunikim dhe bashkëpunim, ato janë në fakt problematika reciprokisht të pretenduara nga ankuesit dhe nga Shefi i Shërbimit, por nuk rezulton që të ketë patur ndonjë vendimarrje nga ana e QSUNT në lidhje përgjegjësinë individuale të gjithsecilit. Në mënyrë të njëanshme QSUNT, pranon si të mirëqëna problematikat në komunikim të ankuesit.

Në lidhje me pretendimin se, ankuesi ka refuzuar kryerjen e detyrave të ngarkuara nga drejtuesi i shërbimit, problematika e referuar është rasti i biopsisë nr.1992/2020. Sipas Shefit të Shërbimit ky rast është refuzuar dhe braktisur nga ankuesi L.B. Referuar akteve të administruara rezulton se për problematikën lidhur me biopsinë nr.1992/2020, është mbajtur korrespondencë midis ankuesit, Shefes së Shërbimit, Zv.Drejtoreshës së QSUNT, znj. A.S, Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Në datën 2.6.2020, ankuesi ka marrë në dorëzim për zgjidhje biopsinë nr.1992/2020. Në po të njëjtën datë ankuesi shprehet se në fletën e biopsisë ka vendosur shënimin që biopsia të kalojë tek Dr.I.C dhe Dr.B.C. Sipas ankuesit, në bazë të ndarjes së subspecialiteteve që Shefja e Shërbimit kishte bërë, bazuar në doktoraturat përkatëse, ankuesi trajtonte sistemin urogenital dhe veshkat, ndërsa mjeket e sipërcituara ishin të profilizuara për biopsinë e palcës së kockës, sikundër biopsia në rastin në fjalë. Ankuesi, referuar korrespondencës në *Whatsapp* me kryelaboranten, i ka kërkuar kësaj të fundit që të marrë masa për të siguruar biopsinë e cila kishte ngelur në korridor, dhe nuk ishte shpërndarë tek mjekë të tjerë.

Me emailin e datës 11.6.2020, ankuesi ka informuar Zv.Drejtoreshën, znj. A.S, në lidhje me problematikën dhe faktin se, në datën 2.6.2020, ai kishte kthyer mbrapsht 2 herë biopsinë, por që drejtuesja këmbëngulte me pa të drejtë, sipas tij, që rasti të zgjidhej prej tij. Ankuesi ka kërkuar që të merreshin masa për zgjidhjen e rastit nga mjekë të profilizuar për biopsinë e palcës së kockës dhe se ai nuk mund të merrte përsipër zgjidhjen e asnjë biopsie që cënon diagnozën e pacientit dhe integritetin e tij juridik-profesional.

Me shkresën nr.2286 prot, datë 3.7.2020 dhe në vijim të kërkesës për informacion në lidhje me rastin, të kërkuar nga Zv.Drejtores znj. A.S, M.I, ka informuar se, biopsia në fjalë ende nuk ishte përfunduar nga ankuesi dhe se, rastet që paraqesin vështirësi në bazë të Rregullores së Brendshme të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, paraqiten brenda 10 ditëve për konsultën e përgjithshme nga mjeku që ka rastin. Ajo informon gjithashtu se, kjo biopsi nuk është ekzaminuar prej ankuesit dhe nuk është nxjerrë për konsultë të përgjithshme nga ana e tij. M.I shprehet se, deri në momentin e referimit të rastit për konsultë të përgjithshme, rasti ishte përgjegjësi e mjekut.

Në vijim të përgjigjes së mësipërme, ankuesit me shkresën nr. 2286/1 prot datë 13.7 2020, të Zv.Drejtores znj. A.S, i është kërkuar informacion në lidhje me biopsinë. Ankuesi ka kthyer përgjigje me shkresën nr.2286/2 prot datë 29.7.2020, duke parashtruar në lidhje me veprimet që ai kishte ndërmarrë në lidhje me rastin.

Nga aktet e administruara rezulton se biopsia në fjalë e cila ishte shpërndarë nga M.I, Shefe e Shërbimit në datën 1.6.2020, ishte zgjidhur në datën 15.7.2020, nga konsulta me tre mjekë, pra pas 1 muaji e gjysëm.

Në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së biopsive, M.I, Shefe e Shërbimit, mbajti qëndrimin se, ka një përvojë të krijuar, e cila në disa raste merret në konsideratë, por volumi i punës dhe nevojat e pacientit janë përcaktuese.

Rregullorja e Brendshme e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, parashikon në pjesën ku përcaktohen detyrat e Shefit të Shërbimit në fushën klinike, në germën “d”, se, ndarja e punës bëhet nga Shefi i Shërbimit, sipas subspecialiteteve. Po në këtë pjesë të rregullores, në germën “b”, parashikohet gjithashtu se, shpërndarja e mjekëve në grupe të ndryshme multidisiplinare bëhet nga ana e Shefit të Shërbimit, sipas subspecialiteteve. Pra, rezulton se ndarja e detyrave për mjekët sipas subspecialiteteve të tyre, nuk është vetëm një përvojë e krijuar pune, por kjo përvojë është saksionuar në një rregull, që Shefi i Shërbimit duhet të ndjekë në kuadër të ushtrimit të kompetencave që ka në drejtim të ndarjes së punës tek mjekët e shërbimit. Kjo do të thotë se, ushtrimi i kompetencave nuk duhet parë vetëm si një e drejtë, por edhe si një detyrim për të ushtruar kompetencat sipas rregullave të përcaktuara në aktet e brendshme rregulluese. QSUNT dhe M.I, Shefe e Shërbimit, nuk kundërshtuan pretendimin e ankuesit L.B se biopsia që i ishte lënë si detyrë nuk i përkiste subspecialitetit të tij, por vetëm se ky i fundit ishte i detyruar që të kryente detyrat që i caktoheshin nga Shefi i Shërbimit.

Rregullorja e Brendshme e shërbimit, në pjesën e detyrave të mjekut të shërbimit, parashikon se kryerja e biopsisë përfundon brenda javës ose 10 ditëve në varësi të ngarkesës dhe vështirësisë së rastit. Rregullorja parashikon se, është Shefi i Shërbimit, ai i cili siguron konsultimin e rasteve në

kohë dhe në cilësi. (germa “b”, pjesa e rregullores për detyrat e Shefit të Shërbimit në fushën klinike).

Ankuesi duke e konsideruar biopsinë që i ishte kaluar për zgjidhje, në kundërshtim me rregullat e shërbimit, nuk e ka pranuar rastin. Rezulton se, nga ana e Shefit të Shërbimit nuk është marrë asnjë veprim në lidhje me pretendimet e ankuesit, nëse ato ishin ose jo të bazuara. Nëse ankuesi me pa të drejtë ka refuzuar kryerjen e detyave, atëherë ai do të duhej të mbante përgjegjësinë e tij, por trajtimi dhe zgjidhja e biopsisë së pacientit duhet të ketë prioritet dhe se aspektet organizative ose burokratike të institucionit, nuk duhet të cenojnë të drejtën e pacientit për të marrë një shërbim të shpejtë. Nuk ka anjë vendimarrje nga ana e organeve eprore të QSUNT, që të ngarkojë me përgjegjësi ankuesin për trajtimin e rastit në fjalë.

Shefi i Shërbimit në bazë të rregullores ka detyrimin që të verifikojë përfundimin në kohë dhe në cilësi të punës së mjekëve. Në rastin në fjalë nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e rastin në kohë. Shefi i Shërbimit i cili është përgjegjës në bazë të rregullores që të verifikojë kryerjen e detyrave në kohë dhe në cilësi, edhe pse ka patur dijeni për situatën dhe mosmarrjen në ngarkim të rastit nga ana e ankuesit, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e biopsisë. Në bazë të rregullores së brendshme të shërbimit parashikohet se, është detyrë e shefit të shërbimit që të sigurojë konsultimet e rasteve në kohë. Konstatohet se, procedurat e ndjekura nuk janë udhëhequr nga nevoja e pacientit, pasi biopsia e cila është përcjellë për ekzaminim në datën 20.5.2020, është zgjidhur në datë 15.7.2020, pra pothuajse pas dy muajsh.

Në lidhje me braktisjen e pacientëve në mënyrë të përsëritur, nga materialet e administruara rezulton se, me shkresën nr. 814/3 prot, datë 25.2.2019, të Drejtores së Burimeve Njerëzore, ankuesit i është tërhequr vëmendja për mosrealizim të plotë dhe në kohë të protokolleve të mjekimit dhe procedurat e tjera të përcaktuara për të sëmurët, si dhe për shkelje të Kodit të Etikës. Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion nga QSUNT, kjo tërheqje vëmendje është dhënë bazuar në konstatimet dhe propozimet e Shefes së Shërbimit, M.I me shkresat nr.814 prot datë 14.2.2019 dhe nr.814/1 prot datë 14.2.2019. Tërheqja e vëmendjes që ankuesit i është bërë me shkresën nr. 814/3 prot, datë 25.2.2019, nuk është marrë nga ana Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, që është edhe autoriteti përfaqësues i QSUNT, por nga Drejtori i Burimeve Njerëzore, në mungesë të tagrave për të vendosur masa disiplinore. Gjithashtu, tërheqja e vëmendjes, nuk mund të konsiderohet një akt që mund të mbahet në konsideratë për të ligjëruar faktin që ankuesi është përsëritës, pasi bazuar në nenin 203/1 të K.Punës, ku parashikohet se : *“Afati i parashkrimit për masën disiplinore është një vit, nga momenti i marrjes së masës disiplinore, njoftuar me shkrim punëmarrësit”*, masa disiplinore “tërheqje vëmendje” është parashkruar dhe si e tillë nuk duhet të ishte marrë në konsideratë.

Në lidhje me vlerësimin e performancës së ankuesit me nr.2574/52 prot., datë 13.08.2019, të kryer nga Shefi i Shërbimit Prof. M.I, tek i cili është bazuar ndër të tjera,zgjidhja e kontratës me

ankuesin, rezulton se, ankuesi ka marrë një vlerësim jo pozitiv në lidhje me performancën e tij. Me anë të këtij dokumenti rezulton se, Shefi i Shërbimit, M.I ka realizuar vlerësimin e performancës së ankuesit për periudhën janar –korrik 2019. Formulari në vetvete nuk ka të përcaktuar një datë se kur është plotësuar performanca dhe nuk përmban nënshkrimin e ankuesit për të cilin është dhënë vlerësimi nga ana e Shefit të Shërbimit. Pra, rezulton se vlerësimi i ankuesit është një vlerësim i njëanshëm, i kryer vetëm nga Shefi i Shërbimit, vlerësim i cili është konsideruar përfundimtar pa i dhënë mundësi ankuesit të parashtrojë qëndrimin dhe kundërshtimet e tij në lidhje me vlerësimin. Në këto kushte një vlerësim i tillë performance që ka cenuar të drejtën e ankuesit për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në lidhje me vlerësimin jo pozitiv që i është bërë, nuk mund të shërbejë si tregues i performacës jo të mirë të ankuesit.

Përveç vlerësimit të performancës së kryer për periudhën janar – korrik 2019, në dosjen e ankuesit nuk rezultojnë të jenë kryer vlerësime të tjera të performacës së tij, në pothuajse 15 vite shërbim që ai ka pranë QSUNT si mjek pedagog. Por, fakti që QSUNT ka vazhduar marrëdhëniet me ankuesin tregon se performanca e tij ka qenë pozitive. Referuar shkresës nr.27/1 prot., datë 06.01.2020 të Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ankuesi ka një vlerësim pune dhe performancë të shkëlqyer si mësimdhënës në lëndën Anatomipatologjike. Sipas letër referencës të lëshuar nga Prof.Dr.M.A në datë 10.3.2021, i cili ka qenë Shef i Shërbimit dhe Shef i Departamentit të Anatomisë Patologjike në QSUNT, në vitet 2008-2018, si epror i ankuesit gjatë këtyre viteve, ai dëshmon se, ankuesi L.B ka patur një performancë të shëlqyer profesionale dhe etike të vazhdueshme në raport me kolegët.

Në lidhje me shkresën nr.3400/40 prot., datë 16.12.2020, reluton se në këtë shkresë M.I, Shefe e Shërbimit, në vijim të kërkesës që i është bërë nga Drejtori i Burimeve Njerëzore në QSUNT, ka sugjeruar që kontrata me ankuesin të mos vazhdojë. Në vijim, rezulton se QSUNT, me shkresën nr.2828/5, datë 24.12.2020, ka njoftuar ankuesin për zgjidhjen e kontratës në datën 31.12.2020, pa i dhënë mundësinë atij që të dëgjohet dhe të mbrohet në lidhje me vendimarrjen e QSUNT për të zgjidhur kontratën.

Bazuar në nenin 15, pikat 1 dhe 2, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, përcaktohet se: “***1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.***

Ankuesi ka depozituar ankesën pranë Komisionerit në datën 10.12.2020 dhe me shkresën nr. 1641/2 prot., datë 18.12.2020 QSUNT dhe M.I, Shefe e Shërbimit, janë njoftuar për paraqitjen e ankesës dhe ndër të tjera është sjellë në vëmendje drejta e ankuesit për të vazhduar punën sipas kushteve të kontratës, gjatë periudhës që ankesa do të shqyrtohej nga Komisioneri. Me

shkresën nr.1844 prot., datë 28.12.2020, Komisioneri kërkoi nga QSUNT, marrjen e masave për të garantuar të drejtën e ankuesit sipas nenit 15, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. QSUNT nuk mori asnjë masë për të garantuar këtë të drejtë të ankuesit, duke vepruar në shkelje të plotë të parashikimeve ligjore të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesit L.B dhe A.N i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, nga ana e M.I, Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në QSUNT dhe QSUNT.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ankuesi L.B, pretendon diskriminim, për shkak të diskriminim *për shkak të bindjeve fetare, gjendjes martesore dhe përkatësisë në një grup të veçantë*, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT) dhe M.I, me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në QSUNT.

Ankuesja A.N, pretendon diskriminim, kundrejt për shkak të diskriminim *për shkak të gjendjes arsimore dhe përkatësisë në një grup të veçantë*, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe M.I, me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në QSUNT.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen për shkaqet e pretenduara nga të dy ankuesit. Konkretisht në nenin 1, të këtij ligji, parashikohet, se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të **barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.**”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për, ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Për të ngritur një pretendim për diskriminim, pala ankuese duhet që minimalisht jo vetëm të identifikojë një ose disa shkaqe mbi bazën e të cilave pretendohet diskriminimi, por duhet edhe të provojë shkaqet e pretenduara.

Në rastin në fjalë, të dy ankuesit pretendojnë se janë diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht, duke patur të dy pretendimin se janë diskriminuar për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Bazuar në shpjegimet e ankuesve, pretendimet për diskriminim për shkak të përkatësisë në grup të veçantë, lidhen me grupin e mjekëve, pedagogëve, specialistëve dhe laborantëve, të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, të cilët kanë paditur M.I, Shefe e Shërbimit, në organin e Prokurorisë Tiranë dhe QSUT-së, lidhur me shkeljet e kryera prej saj gjatë ushtrimit të detyrës. Ankuesit pretendojnë se janë pikërisht paditë e bëra nga një grup punonjësish, duke përfshirë të dy ankuesit, që kanë sjellë trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm ndaj tyre.

Nga aktet e administruara rezulton se ankuesit janë pjesë e një grupi punonjësish të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, të cilët kanë kërkuar nga strukturat drejtuese të QSUNT, fillimin e një hetimi administrativ për të verifikuar pretendimet për kundravajtje administrative ndaj M.I. Ky grup punonjësish, në gusht 2019, ka paraqitur edhe një kallëzim penal në organet e prokurorisë, në adresë të Shefes së Shërbimit, M.I, duke pretenduar se kjo e fundit gjatë ushtrimit të funksionit të saj si drejtuese e këtij shërbimi ka konsumuar veprën penale të vjedhjes dhe falsifikimit të dokumentacionit zyrtar.

Me shkresën nr.2309 prot., datë 07.07.2020, ankuesit së bashku me punonjës të tjerë të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, kanë bërë një tjetër kërkesë drejtuar disa institucioneve përfshirë këtu, Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe Fakultetit të Mjekësisë pranë këtij universiteti, QSUNT, por edhe autoriteteve të tjera si Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet të cilës kanë kërkuar pezullimin e procesit të kandidimit në zgjedhjet për organet drejtuese të Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe pezullimin nga detyra e Shefes së Shërbimit të M.I, për shkak të padive administrative dhe penale ndaj saj.

Ankuesit, pretendojnë pikërisht se, ata vetë dhe punonjësit të cilët kanë paraqitur ankesa dhe kanë marrë pjesë në procedura kundër eprorit të tyre, që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve, përfaqësojnë një grup të veçantë.

Komisioneri, vlerëson se, është karakteristika që i bashkon ankuesit dhe personat e tjerë të cilët kanë paraqitur ankesa dhe kanë marrë pjesë në procedura që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve nga ana e M.I, Shefe e Shërbimit, që në thelb përbën shkakun e vërtetë mbi bazën e të cilit ankuesit pretendojnë se ka shërbyer si shkak për trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të cilit pretendojnë se janë nënshtruar.

Komisioneri gjykon se, diferencat në trajtim bazuar në faktin se, personat kanë paraqitur ankesa që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve nga ana punëdhënësit, duhet të gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat tregojnë se të dy ankuesit e mbartin këtë shkak.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit L.B, për diskriminim për shkak të bindjeve fetare, ky shkak në vetvete është një shkak i mbrojtur në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga neni 1 i ligjit, por, bazuar në analizën e mësipërme nuk rezultoi e provuar se ndaj ankuesit ishin përdorur shprehje fyese për shkak të besimit të tij musliman, Komisioneri vlerëson se, nuk mund të kemi një pretendim për diskriminim, nëse nuk kemi trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm në lidhje me këtë shkak.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit L.B, për diskriminim për shkak të gjendjes martesore, ky shkak në vetvete është një shkak i mbrojtur në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga neni 1 i ligjit, por, bazuar në analizën e mësipërme nuk rezultoi se terminologjia e pretenduar, të konsiderohet si një gjuhë shqetësuese dhe që cënon dinjitetin e personit, Komisioneri vlerëson se nuk mund të kemi një pretendim për diskriminim, nëse nuk kemi trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm në lidhje me këtë shkak.

Në lidhje me pretendimin e ankueses A.N, për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, rezulton se ankuesja e lidh këtë pretendim me statusin e saj si mjeke specializante. Rezulton se ankuesja është duke ndjekur në QSUNT, studimet e specializimit afatgjatë, në programin e studimit të ciklit të tretë në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, për të cilën ka lidhur edhe kontratë me MSHMS. Duke mbajtur në konsideratë se gjendja arsimore, si shkak diskriminimi, ka të bëjë ndër të tjera me nivelin individual të arsimit, Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankueses A.N, për diferencë në trajtim për shkak të statusit të saj si mjeke specializante, gëzojnë mbrojtje në kuadër të shkakut të gjendjes arsimore dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme se ankuesja e mbart këtë shkak.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Nga shqyrtimi i fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se, ankuesit i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm nga ana e M.I, Shefe e Shërbimit dhe QSUNT. Konkretisht, rezultoi e provuar se:

- Ankuesi L.B dhe A.N, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në kuadër të vendosjes së mungesave në listë prezenca dhe heqjen e ditëve të punës.
- Ankuesja A.N i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me kushtet e punës si mjeke specializante dhe se ankesa e saj për fyerje dhe sjelljeve të padëshiruara nga ana e Shefes së Shërbimit nuk është trajtuar në mënyrë efektive.
- Ankuesi L.B, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në kuadër të procedurave të ndjekura për zgjidhjen e kontratës me QSUNT.

Shqyrtimi i pretendimeve, nëse trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe i pafavorshëm të cilit i janë nënshtruar ankuesit, përbën diskriminim, do të bazohet në kuadrin e mëposhtëm ligjor.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Bazuar në nenin 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Ligji, parashikon disa forma përmes të cilave mund të shfaqen sjelljet diskriminuese. Konkretisht në nenin 3, pikat 2, 5, 13 dhe 17, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se: “..... 2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji..... 5. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas..... 13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë..... 17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.....”

Në nenin 5, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet se : “ 1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”

Në Kreun II, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Konkretisht ky ligj, në nenin 12/1/c, parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”,

Në bazë të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlegjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁴

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “ *të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*¹⁵”.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në lidhje me vendosjen e mungesave në listë prezenca dhe heqjen e ditëve të punës, për të dy ankuesit.

Në muajin nëntor 2018 është zhvilluar konkursi për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare. Rezultatet e konkursit kanë shpallur fituese M.I, e cila konkuronte me ankuesin L.B. Nga provat dhe faktet e administruara, rezulton se problematikat në marrëdhëniet midis ankuesit dhe M.I, kanë qenë prezent që prej emërimit të kësaj të fundit si drejtuese e shërbimit.

¹⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁵ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Sipas pretendimeve të ankuesve edhe pse në vazhdimësi, por në mënyrë të veçantë që nga momenti që ata kanë paraqitur ankesa dhe kanë marrë pjesë në procedura kundër drejtueses së shërbimit, duke pretenduar shkelje të rregulloreve dhe ligjeve nga ana e saj, ata kanë qenë nën presion të vazhdueshëm. Kulmi i veprimeve që solli si pasojë edhe paraqitjen e ankesës pranë Komisionerit, ka qenë heqja e ditëve të punës në muajin korrik 2020 për të dy ankuesit.

Nëse i referohemi në mënyrë kronologjike ngjarjeve të ndodhura në muajin korrik 2020, rezulton se, ankuesit, në fillim të muajit korrik 2021 (shkresa protokolluar në QSUNT me nr. 2309 prot., datë 07.07.2020) kanë kërkuar nga QSUNT, pezullimin e Shefes së Shërbimit M.I, me pretendimin e konsumimit të shkeljeve nga ana e saj, shkelje të cilat i janë përcjellë edhe më parë strukturave drejtuese të QSUNT. Me anë të kësaj kërkesë, drejtuar ndër të tjera edhe Universitetit të Mjekësisë Tiranë, ankuesit, kanë kërkuar edhe pezullimin e M.I nga procesi i kandidimit në zgjedhjet për organet drejtuese të këtij universiteti. Me shkresën nr. 2309/1 prot., datë 17.07.2020, QSUNT, i ka kthyer përgjigje, grupit të punonjësve, përfshirë ankuesit, se nuk mund të vendoset pezullimi i M.I nga detyra e Shefes së Shërbimit, për sa kohë që nuk ka ndonjë vendim civil ose penal të formës së prerë për marrjen e masave ndaj saj.

Nga të gjitha aktet e administruara, rezulton se, pavarësisht ankesave nga ana e punonjësve me pretendime për konsumimin e shkeljeve nga ana e M.I, në kuadër të ushtrimit të detyrave si Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, QSUNT, nuk ka marrë asnjë masë për verifikimin e tyre, për të vërtetuar ose për të hedhur poshtë pretendimet e punonjësve për shkelje nga ana e drejtueses së shërbimit. Hetimi penal nga organet e prokurorisë nuk e pamundëson QSUNT, që të ushtrojë mjetet e saj të kontrollit dhe audit të brendshëm, për të verifikuar nëse ka shkelje të natyrës administrative apo disiplinore.

Të dy ankuesit pretendojnë se M.I, si Shefe e Shërbimit, vendos në mënyrë, selektive dhe abuzive mungesa në listëprezencat e shërbimit në lidhje me ta. Nga shqyrtimi i listëprezencave të vendosura në dispozicion rezulton se, ankuesi L.B, në muajin prill 2020 nuk ka asnjë mungesë, në muajin maj 2020 ka 2 mungesa, në muajin qershor 2020 ka 4 ditë mungesë. Ankuesja A.N, nuk ka asnjë mungesë në muajin prill 2020, ka 2 mungesa në muajin maj 2020, dhe asnjë mungesë për muajin qershor 2020. Muaji korrik 2020, i cili kundërshtohet nga të dy ankuesit, rezulton me 9 ditë mungesë për ankuesen A.N dhe me 12 ditë mungesë për ankuesin L.B Ankuesi L.B rezulton që gjatë muajit gusht 2020 të ketë qenë me leje vjetore, ndërsa ankuesja figuron pa asnjë mungesë për këtë muaj. Gjatë muajit shtator 2020, të dy ankuesit figurojnë pa asnjë mungesë në listë prezencat. Duke pretenduar se ankuesi L.B, për një kohë të gjatë nuk paraqitet në mbledhjet e mëngjesit me qëllim për të bërë të mundur verifikimin e prezencës së tij në punë, M.I në cilësinë e Shefes së Shërbimit dhe përgjegjësit për verifikimin e prezencës dhe hartimin e listëprezencës për mjekët e shërbimit, nuk arriti të shpjegojë se si e ka

verifikuar prezencën në punë të ankuesit për periudhën që ai është konsideruar prezent në punë sipas listëprezencave.

Në hartimin e listëprezencave, sikundër është arsyetuar më sipër, në këtë vendim, rezulton se nuk është verifikuar angazhimi i ankuesit si pedagog në Fakultetin e Mjekësisë, sipas parashikimeve të kontratës.

Pra, sa më sipër rezulton se muaji korrik 2020, kur ankuesit kanë përsëritur ankesat e tyre kundër Shefes së Shërbimit dhe kanë rikërkuar marrjen e masave nga ana e QSUNT, është shoqëruar me mungesa në punë për ankuesit, mungesa të cilat sa më sipër është arsyetuar, janë vendosur në mënyrë të padrejtë.

Ankuesit janë ankuar në lidhje me mungesat në punë, të cilat i kanë pretenduar se janë vendosur në mënyrë abuzive nga Shefi i Shërbimit. QSUNT nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të verifikuar pretendimet e ankuesve për prezencën e tyre në punë, por është mjaftuar vetëm formalisht në përcjelljen e pretendimeve të tyre tek Shefi i Shërbimit. QSUNT duhet të kishte verifikuar kryesisht pretendimet e ankuesve për heqje në mënyrë të padrejtë të ditëve të punës dhe jo të mjaftohej me kërkesën drejtuar M.I, për verifikimin listëprezencave. Ankuesit edhe në ankesën e tyre drejtuar QSUNT kanë kërkuar nga kjo e fundit që të verifikonte prezencën e tyre në punë nëpërmjet kolegëve apo punëve që ata kishin kryer. Komisioneri kërkoi vendosjen në dispozicion të biopsive të kryera gjatë periudhës së kontestuar, por informacioni që u vendos në dispozicion, pas disa kërkesave të përsëritura, ishte informacion statistikor dhe jo i ndarë sipas muajve. Ndërkohë që QSUNT duke qënë se e disponon këtë informacion, mund dhe duhet të kishte kryer verifikimet përkatëse, për të hedhur poshtë ose për të vërtetuar pretendimet e ankuesve për shkeljet e pretenduara.

Sa më sipër M.I, Shefe e Shërbimit, në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin e rregullt të dokumentacionit që i dorëzohet drejtorisë së QSUNT, përfshirë këtu edhe listëprezencat, është përgjegjëse për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të cilit i janë nënshtruar ankuesit. Nga ana tjetër, QSUNT, e cila ka detyrimin të verifikojë listëprezencat e hartuara nga Shefi i Shërbimit, ka dështuar që të mbrojë ankuesit nga trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm, të cilit i janë nënshtruar nga ana e M.I, Shefe e Shërbimit.

Në kushtet kur, nga njëra anë rezulton e provuar se, ankuesit i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e M.I, Shefe e Shërbimit dhe QSUNT dhe nga na tjetër, rezulton i provuara shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesit, QSUNT dhe M.I Shefe e Shërbimit kishin barrën e provës për të provuar, që për veprimet e tyre kundrejt ankuesve ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në rastin konkret, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesit janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se trajtimi i padrejtë dhe i

pafavorshëm i ankuesve është kryer për shkak se kanë paraqitur ankesa dhe kanë marrë pjesë në procedura kundër eprorit të tyre, që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve. Në këto kushte M.I, Shefe e Shërbimit dhe QSUNT kishin barrën e provës që të provonin, ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar dhe trajtimit të pafavorshëm, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhnin poshtë pretendimet e ankuesve se këto veprime janë kryer për për shkak se kanë paraqitur ankesa dhe kanë marrë pjesë në procedura kundër eprorit të tyre, që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e tyre, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankuesve, mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesit.

Duke u bazuar në konkluzionet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se M.I, Shefe e Shërbimit të L.B dhe A.N, për shkak se kanë marrë pjesë në procedura kundër eprorit të tyre, që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve, duke shkelur nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, pika 1 dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në lidhje me kushtet e punës si mjekë specializante të ankueses A.N, ankesën për fyerje dhe sjelljeve të padëshiruara nga ana e Shefes së Shërbimit dhe mungesën e një trajtimi efektiv të ankesës nga QSUNT.

Bazuar në informacionin e administruar rezultoi se, në mbledhjen e shërbimit të datës 24.07.2019, ankuesja A.N është përballur me një situatë, me sjellje dhe fjalë të padëshiruara nga ana e Shefes së Shërbimit, gjë që e ka shtyrë ankuesen që të paraqesë ankesë në QSUNT kundër M.I, Shefe e Shërbimit. Edhe pse fjalët fyese si “*rrugaçe*”, nuk rezultojnë të jenë pasqyruar në protokollin e mbledhjes, sikundër pretendojnë M.I dhe QSUNT, kjo e fundit pranon se ka zhvilluar një takim me ankuesen. QSUNT, nuk e kundërshton faktin se, në këtë mbledhje ankuesja është gjendur në një situatë të padëshiruar si pasojë e sjelljes së shefes së shërbimit, pasi pranon vetë se ka patur një problematikë. Komisioneri dëshiron të theksojë se, procesverballi i mbledhjes së datës 24.7.2019 është mbajtur nga M.I ndaj të cilës drejtohet ankesa për përdorimin e fjalëve fyese, si dhe është nënshkruar vetëm prej saj. QSUNT shprehet se, takimi i zhvilluar me ankuesen A.N ka shërbyer për zgjidhjen e problematikës, por në fakt QSUNT me paraqitjen e ankesës nga ana e ankueses duhet të kishte trajtuar ankesën e saj, për të verifikuar pretendimet e ngritura nga ankuesja dhe për të vlerësuar nëse M.I, Shefe e Shërbimit, kishte ose jo përgjegjësi në lidhje me sa pretendonte A.N.

Në shpjegimet e saj QSUNT shprehet se, ky institucion shërben si një bazë pedagogjike për formimin e studentëve të Universitetit/Fakultetit të Mjekësisë, formimin e vazhdueshëm të mjekëve, specialistëve dhe personelit mjekësor, dhe ankuesja nuk ka arsye të ndihet e

diskriminuar për shkak të statusit të saj si mjekte specializante. Gjatë shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit, QSUNT dhe M.I, fillimisht nuk dhanë asnjë shpjegim në lidhje me pretendimet për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankueses për shkak të statusit të saj si specializante. Komisioneri kërkoi në mënyrë të veçantë informacion nga ana e këtyre subjekteve, në lidhje me pretendimet për diskriminim të ankueses për shkak të statusit të saj si specializante. Rezulton se në muajin korrik 2020 (shkresa nr. 2505 prot. datë 30.07.2020), ndaj M.I, është paraqitur një ankesë nga ana e Drejtuesit Mjekësor të PAI-t të Spitalit Onkologjik, z. H.N, i cili ka pretenduar sjellje jo profesionale, fyese e poshtëruese nga ana e M.I, në cilësinë e saj si Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, duke kërkuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj. Kjo ankesë rezulton të jetë vënë në lëvizje nga ana e QSUNT, e cila ia ka përcjellë M.I për të dhënë shpjegimet në lidhje me sa pretendohet në ankesën e paraqitur kundër saj. Në rastin e ankesës së paraqitur nga A.N, QSUNT nuk ka filluar asnjë procedurë për të të verifikuar pretendimet e ankueses, përveç një takimi ku ankuesja vetëm sa është dëgjuar.

Nga aktet e administruara, rezultoi se, vetëm mjekët specializantë përfshihen në shërbimin e recepsionit. Referuar planeve të punës për vitin 2021, specializantët figurojnë të angazhuar në një proces pune i cili figuron i pa emërtuar. Por, në krahasim me kopje të planeve të ngjashme të punës të Shërbimit të Anatomisë për vitin 2019, rezulton se procesi i cili, tashmë nuk emërtohet në planet e punës së shërbimit, rezulton të ketë të bëjë me shërbimin e recepsionit. Një konstatim i tillë bie në kundërshtim me pretendimet e M.I, se mjekët me statusin e specializantit kryejnë të njëjtat procese sikundër mjekët e tjerë të shërbimit.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja A.N, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të gjendjes së saj arsimore, pasi QSUNT ka dështuar që të trajtojë në mënyrë efektive ankesën e saj për sjellje të padëshiruara dhe fjalë fyese nga ana e M.I, Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike. Komisioneri gjykon se, QSUNT, nëpërmjet mosveprimit të saj për të shqyrtuar në mënyrë efektive pretendimet e ankueses për sjellje të padëshiruara, që i kanë cënuar asaj dinjitetin dhe kanë krijuar një mjedis armiqësor, përçmues dhe ofendues, ka dështuar për të mbrojtur në mënyrë efektive ankuesen nga sjellje diskriminuese. Në këto kushte, Komisioneri e gjen QSUNT, në shkelje të nenit 3, pika 13, nenit 5, pika 1 të ligjit nr.10221.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në rastin konkret, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja për trajtimin e saj dhe të mjekëve të tjerë specializantë ndryshe nga mjekët e tjerë të shërbimit, janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i ankueses është kryer për shkak të gjendjes së saj arsimore. Në këto kushte M.I, Shefe e Shërbimit nuk arriti të provojë se:

- nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis përfshirjes vetëm të mjekëve specializantë në bërjen e recepsionit, proces i cili sikundër shpjegimeve të dhëna nga M.I, nuk rezulton të jetë pjesë e proceseve që zhvillohen nga mjekët e shërbimit dhe gjendjes së tyre arsimore;

- ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, se përse bërsa e receptionit, që në fakt nuk është pjesë e proceseve që kryehen nga mjekët e shërbimit, kryehet vetëm nga mjekë specializantë,

në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankueses se këto veprime janë kryer për shkak të gjendjes së saj arsimore.

Në bazë të Rregullores së Brendshme të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, ndarja e punës për personelin, është përgjegjësi e Shefit të Shërbimit.

Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm për diferencën në trajtim që i bëhet ankueses, por edhe mjekëve të tjerë specializantë sikundër ajo, në raport me mjekët e tjerë, në kuadër të proceve të punës në të cilat përfshihen, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja është diskriminuar për shkak të gjendjes së saj arsimore dhe se M.I, Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, ka shkaktuar shkelje të nenit 3/2 dhe 5/1 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankuesja A.N është viktimë e diskriminimit të shumfishtë, pasi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pavaforshtëm, bazuar në dy shkaqe, atë të gjendjes arsimore dhe faktit se ka bërë ankesa kundër eprorit të saj, që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve, shkaqe të cilat kanë prodhuar situata diskriminuese në dëm të ankueses duke vepruar veçmas njëri tjetrit.

Në lidhje me zgjidhjen e kontratës me ankuesin L.B

Nga shqyrtimi i korrespondencës së mbajtur midis ankuesit L.B, QSNUT, edhe pse ky i fundit ka rezultuar me 12 ditë mungesa të pajustificuara sipas listëprezencës së muajit korrik 2020, QSUNT nuk ka ndërmarrë asnjë masë ndaj tij. QSUNT ka patur dijeni për mungesat e pretenduara të ankuesit L.B në muajin korrik 2020, bazuar në listëprezencat të cilat konfirmohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe më pas kalojnë tek strukturat e tjera për kryerjen e pagesave.

Nga njëra anë M.I pretendon se nuk verifikon dot prezencën e ankuesit L.B për një kohë të gjatë dhe nga ana tjetër ai ka vazhduar punën normalisht, prezenca e tij në punë rezulton të jetë verifikuar, pasi ai është pasqyruar prezent në listëprezencat e shërbimit, deri në muajin korrik 2020, kur kanë filluar problematikat me heqjen e ditëve të punës. Pas muajit korrik 2020, kur ankuesit i janë hequr 12 ditë pune, gjatë muajit shtator 2020, ankuesi nuk rezulton të ketë marrë asnjë mungesë, që do të thotë se Shefja e Shërbimit ka mundur të verifikojë prezencën e tij. Pra, rezulton se, pavarësisht se ankuesi që prej tërmetit të muajit nëntor 2019 kryen detyrat e tij nga Katedra e Anatomisë Patologjike, prezenca në punë e ankuesit konfirmohet në varësi të vullneit

të Shefit të Shërbimit. Të gjitha këto mospërputhje ngrejnë dyshime në lidhje me menyrën e mbajtjes së listëprezencave dhe verifikimin e prezencës vetëm nëpërmjet mbledhjes së mëngjesit. Rezulton se palët kanë patur dijeni për faktin se ankuesi i ka kryer detyrat e tij nga Katedra e Anatomisë Patologjike, një mënyrë e tillë e kryerjes së punës është pranuar për sa kohë që ankuesi ka vazhduar prej nëntorit 2019 e më pas që të kryejë detyrat e tij në këtë mënyrë dhe nuk ka patur penalizime.

M.I, Shefe e Shërbimit dhe QSUNT nuk kanë përmbushur detyrimin e parashikuar në kontratë, sipas të cilit në kohën normale të punës së ankuesit si mjek pedagog, përfshihet edhe angazhimi i tij pranë Fakultetit të Mjekësisë, ku ai për periudhën qershor-dhjetor 2020, figuron në listëprezencat e pedagogëve të këtij fakulteti pa asnjë mungesë në punë.

Zgjidhja e kontratës me ankuesin L.B është bërë pa i dhënë mundësinë atij për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në lidhje me vendimin e QSUNT për zgjidhjen e kontratës. QSUNT ka marrë të mirëqëna të gjitha pretendimet për shkelje të referuara nga ana e M.I, pa kryer asnjë verifikim të mëtjetshëm. Ankuesi L.B ka punuar si mjek pedagog pranë QSUNT që prej vitit 2015 dhe nuk rezulton që ai të ketë patur performancë negative në punë apo mosmarrëveshje me drejtuesit e mëparshëm. Vlerësimi negativ i performancës në punë që i është komunikuar ankuesit në gusht 2019, rezulton të jetë marrë pas paraqitjes së ankesave në korrik 2019 dhe në dosjen e tij nuk ka vlerësime të tjera negative. Ndërsa sipas referencës të lëshuar nga ish drejtuesi i Shërbimit të Anatomisë Patologjike, z. M.A, për periudhën 2008-2018, rezulton se ankuesi ka patur një performancë pozitive dhe po ashtu kanë qenë marrëdhëniet e tij me eprorët dhe kolegët.

Rezultoi e provuar se, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga gjatë procedurës së zgjidhjes së kontratës dhe se arsyet e pretenduara për zgjidhjen e kontratës, nuk rezultuan të bazuara. Zgjidhja e kontratës i është njoftuar ankuesit me shkresën nr.2828/5 prot, datë 24.12.2020, ndërkohë që njoftimi i Komisionerit për paraqitjen e ankesës me pretendim diskriminimi kundër QSUNT dhe M.I, nga ana e ankuesit, i është komunikuar këtyre subjekteve me shkresën nr.1641/2 prot., datë 18.12.2020 të Komisionerit.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin përbën një trajtim të disfavorshëm të ankuesit që ka ardhur si pasojë e ankesës për diskriminim të paraqitur pranë Komisionerit. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se, QSUNT e ka diskriminuar ankuesin duke e viktimizuar atë për shkak të ankesës që ai ka paraqitur pranë Komisionerit, ankesë e cila synon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe për rrjedhojë QSUNT ka shkelur nenin 3, pika 17 dhe nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Sa i takon pretendimeve për diskriminim të ankuesit L.B, për diskriminim për shkak të *bindjeve fetare dhe gjendjes martesore*, mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës,

nuk u arrit të provohej trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe i pafavorshëm, i ankuesit lidhur me këto shkaqe.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe nenin 33, pika 10, 11 e 12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesve L.B dhe A.N, nga ana e M.I, me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të ankesave që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve nga ana punëdhënësit.
2. Konstatimin e diskriminimit të ankueses A.N, nga ana e M.I, me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të gjendjes arsimore.
3. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankuesit L.B, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në lidhje me momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
4. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit L.B nga ana e M.I, me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të bindjeve fetare dhe gjendjes martesore.
5. Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për rivendosjen në vend të cënimeve që ankuesit kanë pësuar në pagë, për shkak të heqjes së ditëve të punës.
6. Në referencë të pikës 2, të këtij vendimi, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për trajtimin efektiv të ankesave për shqetësim në vendin e punës dhe parashikimin në rregulloret e saj të brendshme të proceduravë të posaçme për trajtimin e ankesave për diskriminim.
7. Në referencë të pikës 2, të këtij vendimi, nga ana e M.I, me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për ndërprerjen e trajtimit diferencues të mjekëve specializantë dhe mjekëve të tjerë të shërbimit dhe sigurimin e kushteve të barabarta në përfshirjen e mjekëve specializantë në proceset klinike.
8. Në referencë të 3 të këtij vendimi, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të L.B, duke e rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe M.I, me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
10. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
11. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku i diskriminimit: ankesat/gjendja arsimore
Fusha : punësim
Lloji i vendimit: diskriminim
Forma e diskriminimit: diskriminim i drejtëpërdrejtë/ viktimizim/shqetësim